



**ISTOG**

## Strategjia e veprimit për komunitetet

rom, egjiptian e ashkali  
në komunën e Istogut

**2009 - 2011**



# Strategjia e veprimit për komunitetet

rom, egjiptian e ashkali  
në komunën e Istogut  
2009 - 2011



Publikuar nga:  
OJQ "Syri i Vizionit"  
Qendra Zejtare 64/B  
30000 Pejë, Kosovë

Strategjia është hartuar nga OJQ "Syri i Vizionit" Pejë

Mendimet e shprehura në këtë dokument paraqesin pikëpamjet e autorëve dhe jo domosdoshmërisht edhe qëndrimet e Syri i Vizionit, Olof Palme Center dhe Komunës së Istogut.

Botimi i këtij dokumenti është mundësuar nga Olof Palme Center

# Falënderime

Autorët e kësaj strategjie, organizata joqeveritare **"Syri i Vizionit"** falënderon gjithë bashkëpunëtorët, organizatat dhe individët që kanë ndihmuar në procesin e hartimit të këtij dokumenti.

Falënderim i parë është për **Olof Palme Center** për bashkëpunim të mirë dhe mbështetjen financiare që i ka dhënë këtij procesi.

Një falënderim i veçantë për komunën e Istogut, **kryetarin Fadil Ferati** dhe **nënkryetarin e Kuvendit Fazli Stollaj** për përkrahjen ndaj projektit.

Poashtu falënderojmë edhe **zëvendës shefin e Zyrës për komunitete Muhamet Maleshaj** dhe **shefin e Zyrës për kthim Bajram Çelaj**, që kanë qenë aktiv në punë gjatë gjithë procesit të hartimit të strategjisë si dhe **Skënder Avdylin** nga Drejtoria e shërbimeve publike në Pejë, që ka ndihmuar në përlogaritjen e kostos së projekteve.

Falënderimi kryesor është për **përfaqësuesit e komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali të Istogut, kryesuesit e fshatrave, përfaqësuesit politikë dhe të organizatave të këtyre komuniteteve si dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura nëpër fshatra dhe lagje të komunës së Istogut** dhe që me kërkesat, sugjerimet dhe propozimet e tyre kanë kontribuar që ky dokument të jetë më i plotë në përmbajtje dhe më i pasur me ide e propozime.

Falënderojmë: përfaqësuesit e fshatrave të cilët kanë marrë pjesë në takimet e këshillit të përbashkët të fshatrave: **Ismet Krasniqi, Selim Shabaj, Riza Fazliaj, Abedin Neziraj, Rexhë Mulaj, Huta Maleshaj, Deli Ramaj, Abedin Shpatollaj, Mustafë Dautaj e Afrim Istrefaj.**

Anëtarët e fokus grupeve nëpër fshatra që kanë marrë pjesë në takime dhe trajnime: **Imer Krasniqi, Selim Berishaj, Fitim Brahaj, Vehbi Kikaj, Dafina Maleshaj, Ali Stollaj, Milazim Stolaj, Jeton Neziraj, Bajram Mehmetaj, Naim Selmanaj, Mustafë Berisha, Idriz Murselaj, Florim Berishaj, Ismet Zyberaj, Mehmet Selmanaj, Imer Oukaj, Binak Berishaj, Sali Shabaj, Smajl Kameraj, Bajram Krasniqi, Arton Kikaj, Krishk Krasniqi, Xhemë Kikaj, Hasan Shabaj, Imer Zikollaj, Allmire Krasniqi, Metush Zikollaj, Faik Zikollaj, Ibish Bajramaj, Sylë Bajramaj, Ramadan Brahaj, Ismet Keqaj, Afrim Brahaj, Besmir Bajramaj, Nezir Neziraj, Besart Bajramaj, Fatime Krasniqi, Albert Cenaj**

Falënderojmë edhe **z. Zekë Mehaj** nga Gurakoci në lokalitetin e të cilit janë mbajtur takimet e këshillit të përbashkët të komuniteteve.

Autorët e këtij dokumenti ndiejnë të nevojshme të sqarojnë se nëse në tekstin e kësaj strategjie nuk është përfshirë puna ose aktivitetet e të gjithë atyre që kanë punuar në këto komunitet, kjo është e paqëllimshme. Poashtu kërkojmë falje për të gjitha ata që mendojnë se nuk janë përfshirë sa duhet kërkesat dhe sugjerimet e tyre dhe komunitetit të tyre.

# Shkurtesat:

CRPK	- Civil Rights Program Kosovo
IRDK	- Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
KEK	- Korporata Energjetike e Kosovës
PRBK	- Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
PTK	- Post- Telekom i Kosovës
RTK	- Radio televizioni i Kosovës
SDC	- Agjensioni zviceran për zhvillim
SiV	- Syri i Vizionit
SHKA	- Shoqëri kulturore artistike
TMK	- Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UNDP	- United Nations Development Programme (Programi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara)
UNHCR	- United Nations High Commissioner for Refugees (Komisariati i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara)



## Republika e Kosovës

Republika Kosova  
Republic of Kosovo



## Kuvendi i Komunës Istog

Skupstina Opstine Istok  
Municipal Assambly Istog

**Nga:** Komuna Istog

**Për:** OJQ "Syri i Vizionit", Pejë

**Lënda:** Letër mbështetëse për hartimin e Strategjisë për komunitetin rom, ashkali, egjiptian për komunën e Istogut

26 dhjetor 2008

Komuna e Istogut me të gjitha strukturat e saj është e angazhuar për krijimin e një shoqërie shumëetnike në të cilën do ketë barabarësi për të gjithë qytetarët pa asnjë lloj dallimi përkatësie etnike, fetare, gjinore, etj. Në këtë kuptim angazhimi për përmirësimin e kushteve të jetës së të gjitha komuniteteve në këtë komunë është një angazhim i përhershëm i Komunës. Komuniteti rom, egjiptian dhe ashkali i komunës së Istogut është një komunitet që në vazhdimësi ka dhënë dhe jep kontributin e vet në ndërtimin e shoqërisë sonë.

Komuna e Istogut ka përkrahur punën që OJQ "Syri i Vizionit" ka bërë për hartimin e Strategjisë vepruese në komunitetin rom, egjiptian e ashkali në komunën e Istogut dhe e vlerëson këtë si një kontribut për angazhimin e përbashkët për përmirësimin e kushteve të jetës së këtij komuniteti në komunën tonë.

Komuna e Istogut ka bashkëpunuar në hartimin e kësaj strategjie me Syrin e Vizionit gjatë vitit 2008.

Komuna shpreh gatishmërinë dhe angazhimin që me gjithë kapacitetin saj brenda mundësive që ka, të punojë në implementimin e kësaj strategjie.

Me respekt

Kryetar i Komunës së Istogut z. Fadil Fesliu



# PËRMBAJTJA

5	Falënderime
6	Shkurtesat
7	Parathënie
9	Realizuesit
<b>10</b>	<b>I. Hartimi i strategjisë</b>
11	Çka është kjo strategji
11	Korniza ligjore mbi të cilën mbështetet Strategjia
11	Rruga që është ndjekur për hartimin e Strategjisë
12	Pjesëmarrësit në procesin e hartimit të Strategjisë
13	Përfshirja e komuniteteve në hartimin Strategjisë
13	Përfshirja e komunës në hartimin e Strategjisë
13	Gjendja aktuale
13	Shtirja e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali në komunën e Pejës
14	Gjendja në të cilën jetojnë komunitetet rom, egjiptian e ashkali
14	Hulumtimi i kryer nga Syri i Vizionit për gjendjen e këtyre komuniteteve në komunën e Istogut
14	Gjendja e familjeve
15	Gjendja e objekteve të banimit
15	Qasja në shërbimet publike
16	Qasja
16	Zbatimi i Strategjisë
17	Vështirësitë në realizimin e kësaj strategjie
<b>18</b>	<b>II. Iniciativat dhe rekomandimet</b>
19	Hyrje
20	Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale
21	Edukim dhe rini
22	Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
23	Shëndetësia dhe çështjet sociale
24	Anti diskriminimi, siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
26	Kultura, mediat dhe informimi
27	Të drejtat e femrave
<b>28</b>	<b>III. Ndërhyrja në komunitet</b>
29	Hyrje
30	Projektet për fshatin Zallq
33	Projektet për BL Gurrakoc
38	Projektet për fshatrat Drejë- Oprashkë
40	Projektet për fshatin Cërcë
42	Projektet për fshatin Kovragë
43	Projektet për fshatin Gusar
45	Projektet për Istogun e Poshtëm
47	Projektet për fshatin Banjë
49	Projektet për fshatin Dubravë
<b>50</b>	<b>IV. Buxheti</b>
51	Tabela Buxhetore
<b>52</b>	<b>V. Foto</b>
53	Fotografi nga takimet me komunitetet





Olof Palme Center Qendra Olof Palme

Olof Palme International Center punon në bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillim dhe krijimin e opinionit publik i cili ka të bëjë me çështjet ndërkombëtare politike dhe ato të sigurisë.

Palme Centre është themeluar në vitin 1992 nga Partia Social Demokrate e Suedisë, Konfederata e Sindikatës së Tregtisë dhe Sindikata Kooperative. Sot Palme Center ka 28 organizata anëtare brenda lëvizjes së punës.

Qendra punon sipas pikëpamjeve të Kryeministrit të ndjerë të Suedisë, Olof Palme, të cilat reflektohen në citimin e famshëm: "Politika po dëshiron diçka. Politikën Social Demokratike

po dëshirojnë ndryshime".

Bindja e Olof Palmes se siguria e përbashkët krijohet në bashkëpunim dhe solidaritet nëpërmes kufijve, përshkon aktivitetet e Qendrës.

Zotimi i këtyre organizatave anëtare është baza e aktiviteteve të Qendrës. Përveç organizatave themelore, ato përfshijnë edhe Shoqatën Edukuese të Punëtorëve, lëvizjen e banorëve dhe sindikatat individuale. Si lëvizje të popullarizuara dhe organizata vullnetare, ato përfaqësohen në të gjitha komunat e Suedisë dhe në shumë vende pune. Një individ nuk mund të jetë anëtar i Palme Center, por organizatat anëtare së bashku kanë mbi tre milionë anëtarë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar për zhvillim është i përqendruar në gjashtë rajone: Ballkan, Evropë Lindore dhe Rusi, Amerikë Latine, Lindje e Mesme, Azi Juglindore dhe Afrikë Jugore.

Palme Center dhe organizatat e saja anëtare përfshihen në afërsisht 450 projekte zhvillimore ndërkombëtare gjatë një viti. Ato shtrihen prej edukimit qytetar dhe strukturës organizative deri në projektet për të drejtat e njeriut dhe të pajtimit.

Qendra ka një kornizë marrëveshjeje me agjencinë Swedish International Development Co-operation Agency (SIDA), e cila financon projektet për zhvillim ndërkombëtar të organizatave anëtare. Shumica e projekteve zbatohen drejtpërsëdrejti nga organizatat anëtare, të cilat së bashku me partnerët e tyre lokal të bashkëpunimit janë përgjegjëse për planifikimin, inicimin dhe vlerësimin e projekteve. Kjo ndihmon që të krijohen lidhje shumë të fuqishme lokale. Qendra zbaton relativisht pak projekte të zhvillimit ndërkombëtar në vete, me përjashtim nga Ballkani.

Qendra gjithashtu administron fondin International Solidarity Fund (I-Fund), që është lëvizja e punës për solidaritet ndërkombëtar dhe bashkëpunim zhvillimor. Të gjitha mjetet e grumbulluara nga I-Fund përdoren ekskluzivisht për të mbështetur punën e zhvillimit të sindikatave dhe politikave.

Qendra është e bazuar në Stokholmin qendror.



OJQ "Syri i Vizionit"

Organizata Syri i Vizionit është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në Shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë me herët që nga 1999 si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës, duke bërë koordinimin dhe publikimin e revistës për të rinjtë në Kosovë me ndihmën financiare nga USAID-i. Që nga zanafilla, OJQ "Syri i Vizionit" ka arritë profesionalizëm në implementimin e projekteve të një spektri të gjere të projekteve të ndryshme, duke e dëshmuar veten si aktor i mirëfilltë i shoqërisë civile në Kosovë.

Përgjatë viteve të fundit, OJQ "Syri i Vizionit" ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjere të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë në mbare Kosovën dhe Ballkanin si: USAID, IREX, DRC, CARE International, OSCE, Olof Palme, Swiss Labour Assistance, etj.

Qëllimi dhe Vlerat :

OJQ Syri i Vizionit kryesisht ka për qëllim promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë, e sidomos në regjionin e Pejës. Në përpjekjet e vazhdueshme për të implementuar praktika demokratike, OJQ Syri i Vizionit i jep rol të veçantë promovimit të qeverisjes së mire, përgjegjësisë, transparencës dhe pjesëmarrjes në sferat e ndryshme të shoqërisë civile.

Në praktike, çfarëdo projekti i implementuar nga OJQ Syri i Vizionit kërkon për të themeluar lidhje të vazhdueshme në mes të autoriteteve komunale dhe akter të shoqërisë civile në nivel individual ose institucional.

Objektivat e Programit :

Që nga fillimi, OJQ Syri i Vizionit ka artikuluar punën e saj rreth objektivave specifik si:

- Zhvillimi i përgatitjes dhe përhapjes së informative të besueshme dhe testuara tek qytetarët;
- Promovimi i vetëdijes publike lidhur me problemet urgjente sociale tek masa e gjere, nëpërmjet veprimeve që rrisin vetëdijen;
- Pajisja e qytetarëve me mjaft avokim/mbrojtje, si dhe aftësi për lobizim dhe punë ekipore/ të rrjetëzuar në mënyrë që ti praktikojnë të drejtat e tyre elementare dhe të mund të sfidojnë institucionet qeveritare;

Nga 2003, organizata është një nga partneret zyrtar të Web Portalit One World për Evropën Juglindore

Që nga 2004, OJQ "Syri i Vizionit" është bërë anëtar aktiv i Programi i Iniciativës Kosovare (KIP) Organizata merr pjesë në mënyrë aktive në iniciativat tjera për rrjetëzim në baza projekti siç është Platforma Pro Peace e lançuar në Kosovë me pjesëmarrjen e OJQ-ve lokale në 2005, Koalicionin për Parlament të Pastër, Koalicionin "Demokracia në Veprim", Rrjeti për Siguri, dhe Koalicioni për Bashkëpunim në mes Shoqërisë Civile dhe Qeverisë.



# I. Hartimi i strategjisë

## 1.2 Korniza ligjore mbi të cilën mbështetet Strategjia

Strategjia mbështetet në Strategjinë Qeveritare të Kosovës për Romë, Ashkali e Egjiptianë, që është aprovuar në nivel kombëtar në fund të vitit 2007 dhe paraqet bazën lokale të kësaj strategjie, që synon të përmirësojë kualitetin e jetës së komuniteteve rom, egjiptian e ashkali në rajon. Poashtu sikurse dokumenti qeveritar edhe strategjia komunale për komunitetet rom, egjiptian e ashkali mbështetet në rekomandimet e dala nga Marrëveshja e Dekadës Rome (2005-2015) e Bashkimit Evropian. Strategjia është në përputhje edhe me dokumente tjera ndërkombëtare si rekomandimet e Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për politikën ndaj romëve në të cilat rekomandohet qasja afirmative ndaj këtij komuniteti, etj.

Pasi kjo strategji është e hartuar në bashkëpunimin mes komunës, komuniteteve rom, egjiptian e ashkali dhe pjesëmarrësve tjerë me rëndësi në këtë proces, ky dokument do të jetë në shërbim të komunës, që ta shfrytëzojë sipas nevojës ose ta shndërrojë në dokument pune për komunën për periudhën në vazhdim, ose ta paraqesë para donatorëve që mund të shprehin interesim për të vepruar në komunitet.

## 1.3 Rruga që është ndjekur për hartimin e strategjisë

Strategjia është hartuar pas një pune njëvjeçare që OJQ Syri i Vizionit (SIV) ka bërë bashkë me komunitetet rom, egjiptian e ashkali, përfaqësuesit e lokaliteteve të banuara me komunitete, aktivistëve dhe OJQ-ve të komuniteteve si dhe Komunën e Istogut.

Fillimisht "Syri i Vizionit" ka vizituar komunitetet në të gjitha lokalitetet ku jetojnë ai dhe ka mbledhur të dhënat për jetën dhe gjendjen në të cilën jetojnë këto komunitet, për të pasur një pasqyrë më të mirë. Në mungesë të studimeve të mëparshme, në fazën e parë është bërë një hulumtim për të parë gjendjen me shifra dhe fakte konkrete. Hulumtimi është kryer në lokalitetet kryesore ku jetojnë komunitetet rom, egjiptian e ashkali dhe ka qenë i fokusuar në pikat kryesore për të zbuluar gjendjen e familjeve dhe shtëpive në radhët e këtyre komuniteti.

Pas kësaj në lokalitet më të mëdha në komunën e Istogut janë krijuar fokus grupet me pjesëtarë të komuniteteve dhe është

## 1.1 Çka është kjo strategji

Strategjia e veprimit për komunitetet rom, egjiptian e ashkali në komunën e Istogut (në tekstin e mëposhtëm Strategjia) është dokument që synon të parashtrojë gjithë problematikën që kanë komunitetet rom, ashkali e egjiptian në komunën e Istogut. Ajo përmbledh nevojat dhe kërkesat e këtyre komuniteteve në lokalitete ku jetojnë në gjithë territorin e komunës, duke përfshirë problemet e tyre jetësore, kërkesat e komuniteteve dhe zonës në të cilën jetojnë dhe parashtron orientimet e ardhshme të punës në këto komunitete.

Si i tillë ky dokument është një bazë e mirë për komunën, donatorët dhe komunitetet në të ardhmen. Aty janë paraqitur gjithë problematikat, ndarë në sektorë të ndryshëm, janë ofruar zgjedhjet e mundshme dhe është bërë një përlllogaritje e përafërt e kostos së aksionit të veprimit në këto komunitete. Në këtë mënyrë Strategjia përbën një plan aksioni dhe aktiviteti, ajo ngërthen në vete nevojat e komunës dhe komuniteteve.

Strategjia është hartuar nga OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja në bashkëpunim me komunitetet, përfaqësuesit e fshatrave dhe lokaliteteve si dhe me komunën, zyrtarët komunalë për komunitete. Projekti është financuar nga Olof Palme Center.

Projekti është një pilot projekt që synon të mobilizojë dhe trajnojë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që të t'i ndihmojë ata në avokim më të mirë në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës në ndryshimet në jetën e tyre dhe në vendimmarrje. Me projektet që parashihet kjo strategji mendohet të përmirësojë kushtet e jetës së komuniteteve rom, egjiptian e ashkali, komunitete që tradicionalisht kanë jetuar në gjendje të keqe ekonomike dhe pa një minimum ekzistencial, në kushte të këqija banimi dhe infrastrukture.



krijuar një strukturë e njerëzve në terren me të cilët "Syri i Vizionit" ka punuar dhe ka kontaktuar gjatë gjithë hartimit të projektit. Fokus grupet në fillim janë krijuar në fshatrat Zallq, Kovragë, Cërcë, Drejë e Oprashkë e Gurakoc.

Me këto fokus grupe janë zhvilluar takime nëpër secilin fshat ose lagje, në të cilat është diskutuar për temat sipas shtatë problematikave të caktuara. Kanë qenë shtatë sektorë sipas të cilave është diskutuar dhe janë kërkuar rrugët e zgjidhjeve: Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale; Edukim dhe rini; Punësimi dhe zhvillimi ekonomik; Shëndetësia dhe çështjet sociale; Anti diskriminimi, siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi; Kultura, mediat dhe informimi; Të drejtat e femrave. Pasi u është prezantuar komuniteteve projekti, është kërkuar pjesëmarrja e tyre aktive me sugjerimet dhe kërkesat, që kanë ata, pasi në vendet e tyre ata i dinë më së miri problemet dhe nevojat që kanë.

Takimet janë mbajtura në secilin lokalitet, në lagje e në fshatra. Në këto takime janë marrë kërkesat e para, që përbëjnë bazën e parë për hartimin e planit të aksionit. Janë mbajtur dhjetëra takime me grupet, por edhe shumë takime me individuale dhe në grupe më të vogla me përfaqësues të komuniteteve. Gjatë kësaj faze janë kontaktuar edhe përfaqësuesit e komuniteteve edhe në zona tjera të komunës, në fshatrat Banjë, Istog i Poshtëm dhe Gusar, e në fund krejt edhe në fshatin Dubravë. Përfaqësuesit e këtyre fshatrave kanë marrë pjesë në takimet e "këshillit të përbashkët të komuniteteve" me përfaqësues të fshatrave tjera deri në fund të hartimit të strategjisë në proces duke e çuar në dhjetë numrin e lokaliteteve të cilat kanë qenë të kyçura në proces.

Për të aftësuar komunitetet që në mënyrë sa më të mirë të dinë të parashtrojë kërkesat e veta, rrugët e prezantimit dhe avokimin e mëtejshëm, për përfaqësuesit e komuniteteve janë mbajtur tri herë trajnime nga ekspertë për evokim, për draftimin e strategjisë dhe për hartimin e projekt-propozimeve. Herën e parë (gjatë muajit gusht 2008) ata janë aftësuar për të identifikuar problemet në komunitetin ku jetojnë dhe të gjejnë mënyrat e avokimit deri në realizimin projekteve të tyre. Në trajnimin e dytë në muajin shtator 2008 përfaqësuesit e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali janë aftësuar për hartimin e projekt-propozimeve. Trajnimi i tretë për draftimin e strategjisë është mbajtur në muajin shtator dhe me përfaqësuesit e komuniteteve është dakorduar që të përgatisin ata vet dokumentet që do jenë pjesë e strategjisë.

Pas kësaj janë mbajtur takime të përbashkëta me përfaqësuesit e lokaliteteve Zallq, Kovragë, Cërcë, Drejë e Oprashkë, Gurakoc, Banjë, Istog i Poshtëm, Gusarë dhe Dubravë me të cilët është punuar kapitull për kapitull në hartimin e strategjisë. Në këto takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të komunës nga Zyra për komunitete dhe subjekteve politike të komuniteteve.

Strategjia në formën përfundimtare është e bazuar në gjithë materialin e mbledhur në këto dhjetëra takime me komunitetet si dhe kërkesat që në veti ka bërë secili lokalitet. Ajo është hartuar nga "Syri i Vizionit", ndërsa para botimit i është dhënë në shikim dhe diskutim përfaqësuesve të komunitetit në secilin lokalitet dhe komunës.

## 1.4 Pjesëmarrësit në procesin e hartimit të strategjisë

Projekti për hartimin e strategjisë së veprimit për komunitetet rom, egjiptian e ashkali është udhëhequr nga OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja, ndërsa është financuar nga Olof Palme Center. Strategjia në këtë gjendje është rezultat i punës së përbashkët që është bërë gjatë një viti mes "Syrit të Vizionit" dhe pjesëmarrësve tjerë, komuniteteve, organizatave të komuniteteve dhe komunës.

Komunitetet kanë qenë të kyçura në mënyrë aktive dhe kreative gjatë gjithë kohës në projekt. Secili lokalitet ka pasur fokus grupet e veta, grupe prej 7-10 vetësh, që në disa takime të mbajtura kanë dhënë sugjerimet dhe idetë e veta. Për të qenë më aktiv në pjesëmarrje përfaqësuesit e secilit lokalitet kanë ndjekur edhe trajnimet përkatëse për hartim të projekteve dhe për avokim. Sugjerime e mbledhura nga përfaqësuesit e komuniteteve janë përfshirë në draftin e strategjisë, i cili pastaj përsëri në atë formë është analizuar dhe plotësuar me shtesat, sugjerimet dhe kërkesat e komuniteteve.

Komuna e Istogut ka qenë poashtu gjatë gjithë kohës pjesë e punës, pasi ata kanë marrë pjesë në gjithë procesin, duke filluar nga informatat e para që janë marrë nga komuna, nëpër takimet në terren, në trajnime dhe deri në shikimin e variantit përfundimtar.

### 1.4.1 Përfshirja e komuniteteve në hartimin strategjisë

Komunitetet kanë qenë të kyçura në mënyrë aktive dhe kreative gjatë gjithë kohës në projekt në disa mënyrë:

- Komunitetet janë përfshirë direkt në hartimin e strategjisë gjatë takimeve të mbajtura nëpër lokalitetet. Në secilin nga lokalitetet që ka një numër të konsiderueshëm të banorëve janë mbajtur nga disa takime.

- Përfaqësuesit e komuniteteve kanë marrë pjesë në takimet e "këshillit të përbashkët të komuniteteve", takime të mbajtura në Gurrakoc, në të cilat është folur për problemet sipas fushave të përcaktuara.

- Gjatë hartimit të strategjisë janë takuar përfaqësuesit e komuniteteve të mbledhur në subjektet politike, organizatat joqeveritare dhe grupimet tjera që përfaqësojnë komunitetet.

### 1.4.2 Përfshirja e komunës në hartimin e strategjisë

Që nga fillimi i zbatimit të projektit janë mbajtur kontakte me komunën. Kryetari i komunës në dy takimet e para është informuar për procesion e paraparë për hartimin e strategjisë dhe ai ka marrë rol aktiv për të ngarkuar personat përkatës për bashkëpunimin dhe ndihmën e mëtejme gjatë gjithë procesit. Pas kësaj bashkëpunimi kryesisht ka shkuar përmes Zyrës për Komunitete dhe Zyrës për Kthim dhe ka qenë shumë i rëndësishëm për "Syrin e Vizionit" që ka përfituar nga përvoja dhe puna e bërë më parë nga komuna në këtë komunitet. Përveç se ka ndihmuar në rolin këshillues, këto dy zyra kanë qenë pjesëmarrëse në shumicën e aktiviteteve që janë zhvilluar përgjatë rrjedhës së projektit, në fazën kur është prezantuar projekti, pastaj edhe në takime dhe në shikimin e draftit përfundimtar. Informatat e para për terrenin janë marrë nga zyrtarët komunalë të Istogut dhe pastaj kanë shërbyer si bazë për hulumtimin që ka bërë "Syri i Vizionit" në terren. Pas kësaj, zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë edhe në takimet "këshillit të përbashkët të komuniteteve" edhe në trajnime. Zyra e komuniteteve ka marrë pjesë në mënyrë aktive në këto takime me përfaqësuesit e fshatrave dhe ka dhënë idetë dhe sugjerimet, ndërsa kontaktet me zyrtarët komunalë janë mbajtur para dhe pas këtyre takimeve, deri në përfundim të tërë procesit të hartimit të strategjisë.

Zyra për komunitete dhe Zyra për kthim të Komunës së Istogut kanë marrë pjesë edhe në trajnimet që janë organizuar gjatë realizimit të projektit.

Strategjia në formën e draftit para shtypjes së saj i është dorëzuar komunës, kryetarit të komunës Zyrës për Kthim dhe Zyrës për komunitete për të dhënë sugjerimet, për të plotësuar apo shtuar diçka në formën përfundimtare.

## 1.5 Gjendja aktuale

### 1.5.1 Shtrirja e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali në komunën e Istogut

Komunitetet rom, egjiptian e ashkali tradicionalisht kanë jetuar në gjendje të keqe në komunën e Istogut. Ata jetojnë në disa lokalitete por shumica kryesisht janë të orientuar në disa vende: Gurrakoc, Zallq, Dubravë, Drejë, Oprashkë, Gusar, Dubravë, etj. Në numër më të vogël prej disa familjesh ata jetojnë edhe në Istog të Poshtëm, Bainsë, Kashicë, Drejë, Kovragë, Banjë, Veriq, Dragolec e Muzhevinë, etj. Në gjitha këto lokalitete ata jetojnë në fqinjësi me popullatën shumicë shqiptare dhe pakicat tjera, me të cilat mund të thuhet se në vitet e pasluftës kanë jetuar në bashkëfqinjësi të mirë. Kur flitet për lokalitete ku jetojnë komunitetet rom, egjiptian e ashkali nuk bëhet fjalë për lokalitete të pastra etnike, por për lokalitete me popullatë të përzier, por gjithnjë duke qenë këto komunitete vet pakicë ose me numër të njëjtë brenda fshatit. Disa vende si psh në Zallq shumica e shtëpive të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve janë afër me njëra tjetrën por në vende tjera si psh në fshatin Dubravë shtëpitë janë shpërndara anembanë fshatit dhe komuniteti është i organizuar fare pak ose aspak në bazën etnike. Në fshatrave tjerakomunitetetrom, egjiptian e ashkali përbëjnë një pakicë shumë të vogël në kuadër të fshatrave me shumicë dërmuese shqiptare.

Gjatë luftës së viteve 1998-1999 edhe nga këto komunitete kishte shumë të larguar nga Kosova. Pas luftës, pjesëtarët e këtyre komuniteteve kryesisht janë kthyer me iniciativë individuale. Një pjesë është kthyer në mënyrë të organizuar në fshatin Dubravë ku 13 shtëpi në vitin 2002 i ka ndërtuar Agjensioni zviceran për zhvillim SDC në një

projekt të përbashkët të shumë organizatave, kurse edhe 6 shtëpi tjera janë ndërtuar në Cërcë.

Sipas të dhënave të përafërta që ka UNHCR, në komunën e Istogut momentalisht jetojnë 2248 pjesëtarë të këtyre komuniteteve, më saktësisht 2219 egjiptianë, 29 romë, kurse ashkali nuk ka në këtë komunë.

Përderisa në Kosovë nuk ka shifra zyrtare të regjistrimit të popullsisë momentalisht në dispozicion ka shifra të ndryshme. Në këtë dokument për krahasime dhe nevoja të parashtrimit të gjendjes janë përdorur shifrat e përafërta nga UNHCR (për shkak se është një institucion kredibil, kompetent dhe i paanshëm) dhe shifrat që ka nxjerrë vet në terren "Syri i Vizionit".

### 1.5.2 Gjendja në të cilën jetojnë komunitetet rom, egjiptian e ashkali

Një pjese e këtyre komuniteteve jeton në zona pjesërisht të urbanizuara, në shtëpi të vjetra dhe lagje pa infrastrukturë të rrugëve, kanalizimeve, etj. Papunësia në këto lokalitete është më e madhe se kudo tjetër, pasi shumë pak nga pjesëtarët e tij janë të punësuar. Familjet e këtyre komuniteteve shquhen nga jeta në varfëri të thellë. Me shifrat e UNDP nga viti 2004-2005 rreth 77% e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali jetojnë nën minimumin e varfërisë kurse 81 % s'kanë qenë kurrë të punësuar. Shumë prej tyre nuk ndjekin mësimin nëpër shkollë dhe kanë pak qasje në shërbime shëndetësore. Në lokalitetet e tyre ata kanë probleme të pazgjedhura pronësore, pronat e paregjistruara në kadastër dhe probleme tjera që lidhen me tokën.

Organizmi i tyre shoqëror është në nivel të ultë. Ata kanë subjekte politike të komunitetit, porse brenda këtyre komuniteteve organizimet tjera, si organizatat joqeveritare apo organizimet e të rinjve ose femrave, janë fare pak të zhvilluara.

## 1.6 Hulumtimi i kryer nga Syri i Vizionit për gjendjen e këtyre komuniteteve në komunën e Istogut

OJQ "Syri i Vizionit" gjatë shkurt dhe marstë vitit 2008 ka bërë një hulumtim për gjendjen e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në komunën e Istogut. Intervistat e bëra nga hulumtuesit nga OJQ "Syri i Vizionit" kanë mbledhur informacione për gjendjen e familjeve të këtyre komuniteteve dhe objekteve të banimit. Hulumtimi është kryer në pesë lokalitetet më të mëdha të banuara me pjesëtarë të komuniteteve rom, egjiptian e ashkali: Zallq, Dubravë, Shalinoc, Oprashkë e Gurakoc. Në këto vende janë intervistuar të gjithë familjet, nga të cilat intervistuesit kanë marrë të dhënat e përgjithshme dhe ato në tematika të veçanta. Të intervistuarit u janë përgjigjur pyetjeve për numrin e anëtarëve në familje, moshën dhe gjininë e tyre, gjendjen ekonomike-punësimin, të ardhurat, pasurinë dhe pronat. Poashtu në pyetësorët për gjendjen e shtëpive/objekteve të tyre banimit gjatë intervistimeve janë mbledhur të dhënat për madhësinë e shtëpive dhe hapësirën për jetesë për familjet, kohën dhe kushtet e ndërtimit, pajisjen e shtëpive me pajisjet, etj. Intervistimi jep një pasqyrë të plotë të gjendjes dhe kushteve në të cilat jetojnë komunitetet, një pasqyrë kaq të hollësishme nuk e ka bërë asnjë institucion më parë, duke nxjerrë të dhëna të saktësuara për komunitet dhe kushtet në të cilat jetojnë.

### 1.6.1 Gjendja e familjeve

Në këto pesë lokalitete të komunës janë intervistuar të 48 familjet që jetojnë aty. Rezultati ka treguar se në këto fshatra jetojnë 305 persona. Nga të intervistuarit del se familjet mesatarisht përbëhen nga 6.2 anëtarë, 55 % e popullatës në këto familje të intervistuar i takojnë moshës së re deri 24 vjet.

Sa i përket shkollimit, hulumtimi ka nxjerrë na pah se vetëm një numër i vogël i këtyre komuniteteve ndjek shkollimin, posaçërisht kur bëhet fjalë për ndonjë shkollë më të lartë. Nga 161 meshkuj në të gjithë familjet e intervistuar, vetëm 11 kanë shkollë të mesme, ndërsa tek femrat nga 144 sa është numri total vetëm 4 deklarohen të kenë përfunduar shkollën e mesme. Ky trend i keq i së kaluarës vazhdon edhe tani sa i përket arsimimit të mesëm: vetëm shtatë nxënës vazhdojnë mësimin në shkollat e mesme të komunës: gjashtë djem dhe një vajzë. Ndërsa në shkollat fillore gjendja është më e

mirë me 70 nxënës: 37 meshkuj e 33 vajza. Gjendja në arsimimin parashkollor poashtu është e keqe: vetëm dy fëmijë kanë qasje në klasat parashkollore/çerdhe dhe institucione të këtij niveli.

Hulumtimi tregon një gjendje të rëndë sa i përket punësimit: vetëm një person në këto lokalitete është deklaruar se është i punësuar, megjithëse 5 familje kanë thënë se marrin të ardhura mujore mes 100 e 200 euro. 18 familjet tjera kanë të ardhura mujore nën 100 euro.

Të hyrat e pakta që kanë familjet janë kryesisht nga ndihma sociale (rreth 46 përqind) dhe një pjesa më e madhe nga diaspora (54 përqind). Nga të intervistuarit 10 nga 48 familje kanë automjete të motorizuara

### 1.6.2 Gjendja e objekteve të banimit

Sa i përket gjendjes së banimit, intervistimi ka nxjerrë në pah se gjatë luftës 43 përqind e shtëpive kanë pasur dëmtime të rënda të kategorisë V, kurse 50 % e shtëpive të tyre nuk janë dëmtuar. Shumica e shtëpive (77 përqind) janë njëkatëshe, kurse pas luftës janë ndërtuar 50 përqind e shtëpive. Nga të intervistuarit 36 % e shtëpive kanë kualitet të keq ndërtimi. Sa i përket lejeve të ndërtimit, 43% deklarohen që nuk kanë leje ndërtimi, ndërsa 45% deklarohen që nuk kanë pëlqim urban në shfrytëzim.

Në shërbimet komunale ka një qasje të kufizuar për familjet e këtyre komuniteteve. Intervistimi nxjerr në pah se 87 % nuk kanë telefona fiks, por 66 % shfrytëzojnë telefona mobil; 51 përqind e familjeve nuk janë të kyçur në ndonjë ujësjellës por përdorin ujin e pijshëm nga pusët, 77 përqind nuk janë të lidhur me sistemin e kanalizimit, kurse asnjë nga ta nuk përdor deponi legale për grumbullimin e mbeturinave. Përgjigjja ndaj obligimeve nuk është shumë e ultë: 68 % e të intervistuarve deklarojnë se paguajnë tatim në pronë.

## 1.7 Qasja në shërbimet publike

Në lokalitetet ku jetojnë përfaqësuesit e komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali kanë shërbime të përbashkëta me komunitetin shumicë sa i përket shumicës së çështjeve të tyre. Ata ndjekin mësimet në shkollat me shumicë shqiptare, në klasa të përziera ku mësimi bëhet në gjuhën shqipe, gjuhë të cilën të rinjtë e këtyre komuniteteve e njohin mirë dhe nuk e kanë pengesa gjuhësore për të ndjekur mësimin. Për egjiptianët gjuhë amtare është gjuha shqipe.

Shërbimet shëndetësore poashtu ata i kanë në ambulancat e lokaliteteve njëjtë me popullatën shumicë dhe në këtë aspekt komunitetet rom, egjiptian e ashkali kanë të njëjtat shërbime si popullata shqiptare shumicë. Sa i përket shërbimeve sociale pjesëtarët e komuniteteve gëzojnë të njëjtat kushte si gjithë qytetarët e Kosovës. Lidhur me punësimin në institucionet komunale dhe shtetërore, komunitetet kanë një numër të vogël të të punësuarve që nuk arrijnë 15 vetë në institucione të ndryshme komunale. Në aspektin e përfaqësimit, egjiptianët kanë një përfaqësues në Kuvendin Komunal të Istogut, që ka dalë nga subjekti politik i komunitetit ndërsa në Kuvendin e Kosovës, ka 20 vende janë të garantuara për komunitet pakicë në Kosovë.

Problemet e banimit, pronave dhe vendbanimeve joformale që ndeshen, kryesisht janë probleme të fshatit Rudesh dhe Cërcë, kurse në fshatrat tjera nuk ka probleme të tilla.

Problemet e sigurisë nuk paraqesin problem për komunitetet kudo që jetojnë në komunën e Istogut. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë lirinë dhe sigurinë si dhe e shprehin pa ndonjë pengesë përkatësinë tyre etnike dhe fetare.

Për shkak të numrit të vogël të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, mungesës së përvojave dhe kuadrit, këto komunitete deri tash nuk kanë pasur asnjë qasje në media dhe informim. Për problematikat e tyre është shkruar mjaft nga media në gjuhën shqipe, me një qasje që kryesisht ka qenë pozitive dhe afirmuese, por ata nuk kanë pasur ndonjëherë asnjë media të veten.

## 1.8 Qasja

Strategjia iu qaset komuniteteve në mënyrë afirmative. Qëllimi i kësaj strategjie është të afirmojë veprimin pozitiv në raport me komunitetet, në përputhje me orientimet evropiane për veprimin me këto komunitete si dhe në koordinim me politikat e Qeverisë së Kosovës karshi komuniteteve pakicë në Kosovë.

Nga ana formale, problematikave të komuniteteve strategjia iu ka qasur në dy mënyrë: me qasjen në përgjithësi dhe sipas lokaliteteve të veçanta. Qasja e parë ka të bëjë me kërkesat dhe problematikat që kanë të bëjnë me komunitetet në përgjithësi kudo që jetojnë brenda komunës së Istogut. Në këtë pjesë bëhet fjalë për tematika të tilla që s'lidhen me lokalitetin por janë nevoja të përbashkëta për të gjitha. Aty hyjnë kërkesat për informimin, përfaqësimin politik, fushatat e sensibilizimit për shëndetin, etj.

Strategjia është e mbështetur në debatet me komunitetet orientuar në shtatë tema kryesore të konsideruara si më të rëndësishme për komunitetet:

1. Shtëpitë, çështjet pronësore, vendbanimet joformale
2. Edukimi dhe rinia
3. Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
4. Shëndetësia dhe çështjet sociale
5. Anti diskriminimi, siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
6. Kultura, mediat dhe informimi
7. Të drejtat e femrave

Duke llogaritur se çështja e sigurisë dhe ndonjë tjetër nuk janë konsideruar të ndonjë vështirësie të veçantë, në këtë drejtim është bërë më pak, duke u përqendruar në sektorë tjerë ku është menduar se kontributi mund të jetë më i madh për vet komunitetet.

Qasja sipas lokaliteteve të ndryshme ka të bëjë me projekte të veçanta. Kryesisht më të shpeshta në këtë pjesë janë projektet për infrastrukturën, projektet e infrastrukturës rrugore, ujësjellësit, kanalizime, bujqësinë, etj.

Në këtë pjesë gjatë hartimit të strategjisë bashkë me komunitetet "Syri i Vizionit" ka tentuar të bëjë edhe përllogaritjen e përafërt të koston së implikimit buxhetor për projektet e veçanta. Në këtë mënyrë këto kërkesa të komuniteteve kanë marrë formën e mini projekteve, në të cilat sipas një modeli të përbashkët janë përcaktuar disa kërkesa si kostoja e përafërt e llogaritur e çmimit, objektivat dhe qëllimet, përfituesit, etj. Këto të dhëna janë konsideruar si pasqyrë e parë për t'u paraqitur para komunës dhe

donatorëve për të matur mundësinë e angazhimit financiar.

## 1.9 Zbatimi i strategjisë

Ky dokument u adresohet të gjithë institucioneve, organizatave dhe atyre që janë të interesuar për të punuar me komunitetet rom, egjiptian e ashkali në komunën e Istogut. Megjithatë, në radhë të parë Strategjia është hartuar për të qenë në dispozicion të komunës dhe komuniteteve, për nevojat e planifikimit, ndërhyrjes në këto komunitete dhe për të qenë në dispozicion për donatorët.

Strategjia në formën e tillë të hartuar i ofron Komunës një pasqyrë të gjendjes në terren, kërkesat e komuniteteve dhe jep sugjerime për projektet dhe drejtimet e mundshme të zhvillimit dhe investimit në periudhën në vazhdim. Ajo mund të shfrytëzohet nga zyrtarët komunalë në takimet me donatorët të cilët mund të shohin vendin se ku mund të kyçen për të ndihmuar komunën dhe komunitetet.

Me përcaktimin e kërkesave/ projekteve Strategjia jep edhe një përllogaritje të përafërt të koston së ndërhyrjes, kështu që paraqet një tregues të mirë të nevojave të implikimeve buxhetore për vetë komunën ose donatorët, në mënyrë që ata të kenë mundësi të matin mundësitë e tyre dhe angazhimit të tyre në komunitete.

Ajo është një dokument në dispozicion posaçërisht për vet komunitetet, përfaqësuesit e tyre, qoftë në institucionet politike, qoftë të shoqërisë civile për të kërkuar projekte dhe zhvillimin e komuniteteve. Ajo do të jetë një dokument i rëndësishëm që pasqyron gjendjen e tërësishme të komunitetit të tyre, mundësitë dhe perspektivat.



## 1.10 Vështirësitë në realizimin e kësaj strategjie

Autorët e strategjisë e kuptojnë që gjitha rekomandimet dhe sugjerimet që dalin nga ky dokument nuk mund të plotësohen përnjëherë, as në një periudhë të shkurtë. Ato mbesin si orientime të vazhdueshme për institucionet dhe shoqërinë në një periudhë afatmesme dhe afatgjate. Por disa nga kërkesat sipas sektorëve dhe disa nga projektet dallohen për urgjencën me të cilën duhet ndërhyrë në to. Prioritet në këtë aspekt paraqitet nevoja për të ndërhyrë në sektorët e shëndetësisë dhe çështjeve sociale, punësimit, të drejtat e njeriut dhe antidiskriminimit, posaçërisht fëmijëve dhe femrave. Këto kërkojnë ndërhyje të shpejtë, ndërsa edhe sektorët tjerë janë poaq të rëndësishëm dhe me nevojën që sa më parë të veprohet në to.

Autorët e strategjisë janë të vetëdijshëm për disa vështirësi që do të ndikojnë në realizimin e kësaj strategjie. Vështirësi kryesore në këso raste janë mungesa e mjeteve financiare për plotësimin dhe jetësimin e nevojave që ka komuniteti. Komunitetet rom, egjiptian e ashkali në lokalitetet ku jeton kanë nevojë për ndryshime të mëdha duke filluar nga infrastruktura dhe mënyra jetës e deri në ndryshimin e qasjes dhe mënyrës se si institucionet dhe shoqëria merret me ta. Mundësia reale e institucioneve qendrore dhe lokale, buxhetit dhe shoqërisë kosovare janë shumë të kufizuara, ndërsa nevojat janë të mëdha dhe kërkesat vijnë nga të gjitha komunitetet dhe nga të gjitha kategoritë. Poashtu është e ditur se numri i donatorëve, ku hyjnë fonde dhe organizata ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe në komunën e Istogut, është zvogëluar, prandaj edhe mundësia e përkrahjes për projektet e komuniteteve është më e vogël tash. Një tjetër vështirësi është nga vet komunitetet, gjendja e tij ekonomike e sociale, mungesa e zhvillimit, mungesa e elitës kulturore që do u printe këtyre komuniteteve për të identifikuar nevojat e tyre dhe rrugët e zgjedhjes, mungesa e kuadrove të shkolluara nga radhët e këtyre komuniteteve, etj. Komunitetet nuk janë të organizuara sa duhet, nuk ka konkurrencë mendimesh dhe idesh, në kuadër të kësaj komune, përveç dy subjekteve politike nuk ka gati asnjë formë tjetër të veprimit. Edhe në rastet kur ka pasur tentime për të krijuar organizata joqeveritare apo grupime tjera, ato nuk kanë arritur të marrin ndonjë rol me rëndësi në jetën e komuniteteve. Vështirësi në këtë aspekt paraqet fakti se pjesëtarët e komuniteteve janë shpërndarë nëpër lokalitete të ndryshme që shumë herë janë larg nga njëri tjetri, në bashkësi të vogla

që shumë herë nuk e kalojnë numrin e dhjetë familjeve në një fshat. Në këtë mënyrë komunikimi dhe ndërveprimi brenda komuniteteve është i paktë dhe mundësia e organizimit të përbashkët është e vogël. Sa i përket projekteve për punësim vështirësitë shtohen nga fakti se në Kosovë dhe komunën e Istogut papunësia është shumë e madhe, numri i vendeve të punës që mund të hapen është shumë i vogël dhe kjo bën të vështirë përfshirjen e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në projektet për punësim.

Vështirësia e fundit që duhet përmendur është për faktin se Strategjia është joobligative në kuptimin që nuk ka ndonjë organ përgjegjës i cili do zbatonte këtë dokument. Në këtë aspekt institucionet dhe donatorët vendosin vet për mënyrës se sa dhe si do të plotësojnë rekomandimet që dalin nga ky dokument. "Syri i Vizionit" inkurajon institucionet që të shfrytëzojnë sa më shumë këtë dokument dhe të plotësojnë aq sa munden nga kërkesat që dalin nga ky dokument.



## II. Iniciativat dhe rekomandimet

## 2.1 Hyrje

Strategjia iu qaset komuniteteve në dy mënyrë: me qasjen në përgjithësi dhe sipas lokaliteteve të veçanta. Qasja e parë ka të bëjë me kërkesat dhe problematikat që kanë të bëjnë me komunitetet në përgjithësi kudo që jetojnë brenda komunës së Istogut. Në këtë pjesë bëhet fjalë për tematika të tilla që s'lidhen me lokalitetin por janë nevoja të përbashkëta për të gjitha. Aty hyjnë kërkesat për të drejtat e njeriut, informimin, përfaqësimin politik, fushatat e sensibilizimit për shëndetin, etj. nga të cilat përfiton gjithë komuniteti në secilin lokalitet, përfshirë edhe lokalitete të vogla në të cilat ka vetëm disa familje.

Strategjia është e mbështetur në debatet me komunitetet orientuar në shtatë fushat kryesore të konsideruara si më të rëndësishme për komunitetet. Përzgjedhja e këtyre fushave ka dalë nga puna që Qeveria ka bërë në përgatitje për hartimin e strategjisë për komunitetet rom, egjiptian e ashkali gjatë vitit 2007. Ato janë:

1. Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale
2. Edukimi dhe rinia
3. Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
4. Shëndetësia dhe çështjet sociale
5. Anti diskriminimi, siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
6. Kultura, mediat dhe informimi
7. Të drejtat e femrave

Në të vërtetë në shumicën e rasteve, problematika me të cilat përballet komuniteti rom, egjiptian e ashkali është e përgjithshme, për të gjitha komunitetet, pra nuk flitet për probleme që i përkasin ose janë vetëm të komuniteteve rom, egjiptian e ashkali. Me të njëjtën problematikë në shumicën e rasteve përballet edhe vet komuniteti shumicë shqiptar siç janë çështjet e vendbanimeve joformale, mungesa e infrastrukturës jetësore dhe asaj të zhvillimit ekonomik, shërbimet jo edhe aq të mira shëndetësore, mungesa e përkrahjes sociale, etj. Por ka edhe problematika që janë të veçanta për komunitetet rom, egjiptian e ashkali sikurse çështjet e kulturës dhe informimit, apo deri diku edhe arsimit dhe barazia gjinore.

Duke llogaritur se çështja e sigurisë dhe ndonjë tjetër nuk janë konsideruar të ndonjë vështirësie të veçantë në komunën e Istogut, në këtë drejtim i është dhënë më pak vëmendje në strategji, duke u përqendruar në sektorë tjerë ku është menduar se kontributi mund të jetë më i madh për vet komunitetet.



## 2.2 Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale

**Përshkrimi i gjendjes:** Komunitetet rom, egjiptian e ashkali në komunën e Istogut në pjesën më të madhe jetojnë në bashkësi me shumicën shqiptare dhe komunitetet tjera. Për këtë arsye çështja e banimit të këtyre komuniteteve në këtë komunë shtrohet bashkë me të gjitha komunitetet tjera. Në këtë aspekt komuna e Istogut ka disa vendbanime joformale nga të cilat dy janë lokalitete ku jetojnë komunitetet rom, egjiptian e ashkali. Në fshatin Rudesh të Istogut është i ndaluar rindërtimi i shtëpive për shkak se është një nga të ashtuquajturat "zona të mbrojtura" sipas planit të Ahtisarit. Në këtë vend ndodhet një kishë serbe dhe për shkak të saj nuk lejohet ndërtimi i shtëpive. Para luftës në këtë vend kanë jetuar 72 familje të komunitetit egjiptian, një pjesë e të cilave kanë shtëpi dhe prona në këtë vend. Komuna ka ofruar një plan sipas të cilit këtyre banorëve do t'u jepej në shfrytëzim toka në fshatin Serbobran në të cilin ata do ndërtonin shtëpitë. Në Cërcë ka një zonë të vogël joformale e përbërë nga disa shtëpi, mes tyre 4 shtëpi të komunitetit egjiptian. Edhe për këta banorë plani i komunës parasheh të njëjtën zgjidhje, dhënien në shfrytëzim të tokës në fshatin Serbobran.

Sa i përket regjistrimit të pronave, shtëpive dhe objekteve të banimit, problemi në këto komunitete është poashtu i njëjtë me atë në komunitetet tjera. Në një të kaluar më të largët, shitblerjet i kanë bazuar në marrëveshje gojore dhe nuk i kanë bartur në kadastrën komunale, për këtë arsye shumë nga qytetarët nuk kanë pronat e tyre të regjistruara. Bëhet fjalë sidomos për shitblerjet që janë bërë në periudhën nga vitet 50-80 të shekullit të kaluar. Në këtë aspekt komunitetet rom, egjiptian e ashkali për shkak të analfabetizimit më të madh, ndoshta e ka më të theksuar se të tjerët këtë problem. Problemi i të pastrehëve në komunitetet rom, egjiptian e ashkali është një problem që tradicionalisht është lidhur me mënyrën e jetës së një pjesë të këtyre komuniteteve, që gjithmonë ka qenë e pastrehë, por edhe me dëmet e luftës që ka shkatërruar shtëpitë e qytetarëve të komunës së Istogut. Rreth 110 shtëpi janë ndërtuar për pjesëtarët e komuniteteve në kuadër të proceseve të kthimit dhe rindërtimit në periudhën e pasluftës. Në formën e problemit të shtruar momentalisht nga komunitetet ky problem shtrohet në Rudesh, ku poashtu ka pronarë që kanë një sasi fare të vogël prone, por edhe ata

që kanë pronë nuk e kanë të lejuar të rindërtojnë. Në raste të veçanta problemi i strehimit haset edhe në fshatra tjerë që kanë qytetarë të pastrehë që s'kanë as pronë, as shtëpi.

Probleme ka edhe me pajisjen e qytetarëve me dokumente identiteti. Ka njerëz që asnjëherë nuk janë regjistruar në gjendje civile, nuk ekzistojnë në dokumentacion dhe për pasojë nuk kanë asnjë lloj dokumenti identifikimi. Kjo ka qenë një problem në të kaluarën por edhe tash është i pranishëm posaçërisht me fëmijët që lindin jashtë spitaleve.

### Iniciativat ekzistuese:

Istogu ka të hartuar Planin urbanistik dhe zhvillimor, ndërsa në periudhën në vazhdim do ndërtohen planet e hollësishme rregulluese. Përfundimi i planit të formalizimit të të gjitha zonave do të sqarojë veprimet direkt të punës nëpër këto lagje dhe në të njëjtën kohë do të verifikonte më afër nevojën e banorëve për legalizimin e shtëpive dhe ndërtimet e mundshëm në të ardhmen.

Komuna ka përpunuar planin për dhënien në shfrytëzim të 2.5 hektarëve tokë në fshat Serbobran për pjesëtarët e komunitetit rom, egjiptian e ashkali të komunës së Istogut. Qytetarëve të pastrehë dhe atyre që kanë problem me formalizimin e lokaliteteve ku jetojnë, do t'jepeshin nga 5 ari tokë në shfrytëzim. Nga ky plan përfitojnë qytetarët e Rudeshit dhe Cërcës.

Deri më tani nga institucionet vendore dhe donatorët ndërkombëtare janë ndërtuar së paku 110 shtëpi të komunitetit. Për vitin 2009 Komuna me UNDP me fondet qeveritare do ndërtojnë 18 shtëpi në komunën e Istogut nga të cilat së paku 3 do jenë për komunitetet rom, egjiptian e ashkali.

Nga 20 familjet që kanë përfituar nga një banesë në ndërtesën e strehimit kolektiv financiar nga Emiratet e bashkuara Arabe, një banesë ka përfituar edhe një familje egjiptiane.

Sa i përket çështjes së regjistrimit dhe pajisjes me dokumente identifikimi për personat e paregjistruar, një organizatë ndërkombëtare me emrin CRPK po realizon një projekt në të cilin përfshihet edhe zgjidhja e këtyre rasteve. CRPK është një organizatë ndërkombëtare që merret me regjistrimin e romëve dhe egjiptianëve që nuk janë të regjistruar. Ata shtrijnë aktivitetin tyre edhe në Pejë ku kanë një zyrë në shërbim të këtyre komuniteteve.

### Rekomandime për veprime të mëtejme:

- të zgjidhet problemi i strehimeve në zonat joformale në Rudesh dhe Cërcë
- plani për dhënien e tokës në Serbobran të miratohet nga Kuvendi komunal
- t° kërkohen donatorë që të vazhdonin

- *procesin e rindërtimit të shtëpive të përfshihen në projektet e ndërtimit social anëtarët e këtyre komuniteteve që nuk kanë pronë/shtëpi banimi*
- *të shikohet mundësia e dhurimit të trojeve nga komuna për ata pjesëtarë të këtyre komuniteteve që nuk kanë pronë për të ndërtuar shtëpi*

## 2.3 Edukimi dhe rinia

**Përshkrimi i gjendjes:** Nxënësit e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali ndjekin mësimet në gjuhën shqipe në shkollat të përbashkëta në komunën e Istogut. Ata janë të integruar në klasa të rregullta bashkë me nxënës të komunitetit shumicë shqiptar dhe komuniteteve tjera. Por për shkak të nivelit të ultë të vetëdijesimit, gjendjes së rëndë ekonomike dhe për arsye tjera, megjithatë shumë fëmijë romë dhe egjiptianë mbesin jashtë shkollave, disa prej tyre duke u larguar nga shkolla nga prindërit në një moshë shumë të re. Edhe pse me ligjet ekzistuese në Kosovë arsimit nëntë vjeçar është obligues, një pjesë e mirë e prindërve nuk i dërgojnë fare apo i largojnë fëmijët nga shkolla ende pa kryer shkollën fillore. Ata fëmijë pastaj shfrytëzohen për punë, apo aktivitete për mbajtjen e familjes.

Sa i përket shkollimit, një hulumtim i kryer në muajt shkurt dhe mars të vitit 2008 në pesë lokalitete më shumë të madh të banorëve në komunë: në Zallq, Gurrakoc, Dubravë, Oprashkë e Shalinoc, ka nxjerrë në pah se vetëm një numër i vogël i këtyre komuniteteve ndjek shkollimin, posaçërisht kur bëhet fjalë për ndonjë shkollë më të lartë. Vetëm 15 vetë thonë se kanë përfunduar shkollë të mesme. Ky trend i keq i së kaluarës vazhdon edhe tani sa i përket arsimimit të mesëm: vetëm shtatë nxënës vazhdojnë mësimin në shkollat e mesme të komunës: gjashtë djem dhe një vajzë.

Komuniteti egjiptian në rajonin e Istogut gjuhë amtare e ka gjuhën shqipe kështu që në arsimim nuk ka probleme me gjuhën, ndërsa komuniteti rom ka gjuhën e vet të vjetër, gjuhën rome. Megjithatë ky komunitet në shtëpi, në komunikim të përditshëm përdor gjuhën shqipe. I pakët është numri i pjesëtarëve më të rinj të komunitetit rom që di më shumë se ndonjë fjalë në gjuhën rome. Në këtë aspekt sa i përket arsimimit të tyre përdorimi i gjuhës shqipe në shkollë nuk paraqet vështirësi.

Një çështje e ngritur si nevojë për shkollimin e këtyre komuniteteve është edhe ajo për organizimin e mësimin plotësues. Pasi një pjesë e komuniteteve është analfabete, nxënësit - posaçërisht ata të klasave të ulëta, kanë probleme të mësimin. Këta fëmijë kanë prindër që nuk dinë shkrim lexim dhe kjo vlerësohet si një nga arsyet se pse suksesi i tyre në shkollë është i dobët, për shkak se nuk kanë mbështetjen dhe ndihmën në shtëpi për të kuptuar mësimet dhe detyrat e shtëpisë. Për këtë arsye mbajtja e mësimin shtesë për këta nxënës konsiderohet e nevojshme në mënyrë që të përmirësohet rezultati i këtyre nxënësve. Poashtu për të rinj dhe nxënës të këtyre komuniteteve mund të organizoheshin klasat e mësimin intensiv. Bëhet fjalë për ata që kanë kaluar moshën për të filluar mësimin në klasat fillore pa shkuar në shkollë, ose që i kanë lënë përgjysmë mësimin. Për ta do të mundësohej një shkollim i shpejtë me programe të reduktuara, që në afat të shkurtë të kryejnë arsimimin nevojshëm elementar. Ky lloj mësimi do ishte edhe kontribut kundër analfabetizmit të këtyre komuniteteve.

Ashtu si gjithë komunitetet rom, egjiptian e ashkali, ashtu edhe rinia në komunën e Istogut nuk ka ndonjë organizim të mirë. Disa subjekte joqeveritare të këtyre komuniteteve kanë ndërmarrë disa nisma dhe në projekte të ndryshme kanë përfshirë disa të rinj në aktivitete rinore, por kjo s'është e mjaftueshme. Edhe brenda subjekteve politike të komuniteteve nuk ekziston organizimi e as prania e komponentit rinor.

Pasi që një pjesë e madhe e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali jetojnë në varfëri të skajshme një barrë e madhe për të mbajtur familjen bie shpesh mbi të rinjtë që shumë herë shfrytëzohen nga familja që në moshë shumë të re për të punuar dhe mbajtur familjen. Ata largohen shpesh nga shkollat pa marrë as arsimin fillor. Si pasojë mundësia e këtyre të rinjve për të marrë arsimim por edhe për një formim elementar kulturor janë shumë të vogla ose pothuaj asfare. Ata nuk janë të përfshirë në kurrfarë aktiviteteve kulturore, sportive e rekreative.

### Iniciativat ekzistuese:

Gjatë viteve 2002-2003 në Gurrakoc e Zallq të Istogut është mbajtur mësimi intensiv për pjesëtarët e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali. Ky lloj mësimi i organizuar nga Ministria e Arsimit u ka mundësuar pjesëtarëve të këtyre komuniteteve që në një afat të shkurt të kryejnë në mënyrë të përshpejtuar arsimin fillestar për ata që për shumë arsye nuk kanë qenë të përfshirë në procesin arsimor. Programi ka pas një kohëzgjatje të limituar.

Tek të rinjtë e komuniteteve rom, egjiptian e

ashkali në Istog ka një sektor të organizmit joqeveritar, të cilat edhe pse kanë nevojë të forcohen edhe më shumë, mund kanë mbledhur rininë në aktivitete të ndryshme dhe organizime të jetës rinore. Funkcionojnë dy OJQ rinore të komunitetit, "Vizioni 02" dhe "Piramida".

Ekziston edhe grupi joformal "Yjet" që tubon rreth 60 të rinj dhe merret me organizimin e programeve kulturore e argëtuese për të rinjtë e Istogut, programe artistike që angazhojnë të rinjtë e të gjitha komuniteteve.

Në Dubravë ka një qendër kulturore për të rinjtë, e cila nuk shfrytëzohet sa duhet, por me ide të reja mund të vihet në veprim. Në fshatin Zallq ka një fushë sporti që mund të riparohej dhe të shërbejë për organizime sportive të komunitetit. Po aty ka vend edhe për një park me lodra sipas kërkesës së qytetarëve.

### **Rekomandime për veprime të mëtejme:**

- të organizohet mësim shtesë për nxënësit e këtyre komuniteteve
- të mbahet mësimi intensiv për nxënësit që nuk janë të përfshirë në procesin arsimor
- të mbulohen shpenzimet e udhëtimit të pjesëtarëve të komunitetit që për shkak të gjendjes ekonomike nuk mund të ndjekin shkollimin
- të punohet më mësuesit dhe nxënësit në mënyrë që ketë një trajtim të barabartë për nxënësit rom, egjiptian e ashkali nëpër shkolla
- të përfshihen të rinjtë në aktivitete kulturore e sportive
- të përkrahet realizimi i projekteve për organizimin dhe fuqizimin e rinisë rome, egjiptiane e ashkali, duke filluar nga organizatat rinore, klubet sportive, etj
- të ndahet ndonjë bursë për shkollimin e studentëve të komuniteteve rom, egjiptian e ashkali

## **2.4 Punësimi dhe zhvillimi ekonomik**

**Përshkrimi i gjendjes:** Komunitetet rom, egjiptian e ashkali që jetojnë në komunën e Istogut përbëjnë një komunitet të vogël në kuadër të popullsisë së përgjithshme të komunës. Ata janë 2248 banorë në një komunë me mbi 50 mijë banorë. Numri i atyre që punojnë nuk është shumë i madh, pasi që jo vetëm komunitetet, por i gjithë rajoni përballen me papunësi të madhe ku një pjese e mirë e popullatës së komunës jeton në kushte të vështira dhe varfëri. Sipas të dhënave që "Syri i Vizionit" ka mbledhur nga gjendja në terren rezulton se në institucionet shtetërore punojnë jo më shumë se 14 vetë. Në administratën komunale dhe tre sektorët kryesorë të saj punojnë 5 pjesëtarë të këtij komuniteti, nga një në TMK dhe polici dhe 7 në Burgun e Dubravës. Në shërbimet KEK, PTK, ujësjellës dhe higjienë nuk ka asnjë të punësuar.

Pjesa tjetër kryesisht janë të papunë. Familjet e tyre jetojnë në varfëri ekstreme në kushte minimale ekzistenciale, pa shumë perspektivë. Shkaqet pse ndodh një gjendje e tillë janë të shumta, ato vijnë nga e kaluara dhe një pozicion në të cilin këto komunitete nuk kanë qenë të organizuara mirë dhe nuk kanë ditur t'i paraqesin kërkesat e veta. Shkak është edhe vetëdija e ultë, mungesa e organizimit më të fortë, dhe pozicionit më inferior në raport me komunitetet tjera. Poashtu bazuar në gjendjen faktike shihet se për shumë vende pune mungon kuadri përkatës, por edhe kur ka kuadër të kualifikuar, ata nuk kanë shumë punë.

Në mesin e këtyre komuniteteve nuk ka ndërmarrës iniciativash në sektorin privat, të cilat mund të krijonin mundësi për punësim dhe vetmbajtje. Kjo vjen edhe nga shkak se një pjesë e kësaj popullatë nuk ka prona, nuk ka punë (rrogë) dhe për pasojë edhe nuk ka shumë qasje në banka dhe mundësi të marrjes së kredive për fillim biznesi. Në të kaluarën një pjesë e mirë e këtyre komuniteteve kanë punuar dhe janë vetmbajtur me profesione që kanë qenë zanate të trashëguara në këto komunitete. Ata janë angazhuar duke punuar si kovaçë, karrocierë, shitës të hekurishteve, mbajtës dhe shitës të kuajve, etj., profesione që tashmë kanë humbur rëndësinë dhe nuk ofrojnë shumë mundësi. Një pjesë e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve vazhdon të jetojë duke mbledhur hekurishtet dhe duke tubuar materiale tjera ricikluese nga mbeturinat, në mënyrë që pastaj t'i shesin ato. Kurse pjesa ekzistojnë pjesërisht duke punuar tokën bujqësore, punë që nxjerr përfitime minimale për familjet. Diaspora është e rëndësishme për mbajtjen e komunitetit. Pjesa

më e madhe e të hyrave në komunitet vjen pikërisht nga anëtarët e familjeve që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës Perëndimore.

### Iniciativat ekzistuese:

Një numër prej rreth 14 pjesëtarëve të këtyre komuniteteve tashmë është punësuar në institucionet e ndryshme shtetërore komunale dhe rajonale. Janë 5 të punësuar në komunë (administratë, arsim e shëndetësi), nga një në TMK dhe polici dhe 7 në Burgun e Dubravës. Edhe pse ky numër është i vogël kjo paraqet një bazë të mirë për fillim dhe ka thyer tabunë e dikurshme lidhur me punësimin e këtyre komuniteteve, që në një të kaluar të afërt kishte rrallë ndonjë të punësuar në sektorin shtetëror.

Një pjesë e mirë e këtij komuniteti ka prona tokë bujqësore dhe në projekte të ndryshme nga organizata që kanë punuar në terren, ata kanë përfituar ndihmë për zhvillimin e bujqësisë, mjete të punës dhe vegla bujqësore për përpunimin e tokës, si dhe fond blegtoral, bagëti më mëdha e të vogla. Projektet e tilla kanë qenë të përfitimit individual për familjet e veçanta e jo për tërë komunitetin. edhe procesi i kthimit ka qenë i shoqëruar nga procesi i gjenerimit të ardhurave për vetmbajtje për familjet e kthyer në kuadër të cililit për çdo familje është dhënë një ndihmë varësisht nga kërkesa që ka pasur familja. OJQ "Vizioni 02" në kuadër të projekteve të tij ka bërë aftësimin në profesione të ndryshme të dhjetëra pjesëtarëve të komunitetit. Meshkujt janë aftësuar në profesioni si elektrikist, agjustator, kurse femrat për rrobaqepësi, frizere, etj.

Në kuadër të komuniteti ka një numër të vogël sipërmarrësish tregtar që kanë filluar bizneset e tyre të vogla. Me përkrahjen dhe zhvillimin e tyre ata mund të punësonin edhe anëtarë tjerë të komunitetit.

### Rekomandime për veprime të mëtejme:

- *institucionet me financim nga buxheti i Kosovës në radhët e tyre të punësojnë pjesëtarë të këtyre komuniteteve*
- *posaçërisht duhet punësuar pjesëtarë e këtyre komuniteteve në projektet që kanë të bëjnë me këto komunitete*
- *të përkrahin projektet për ferma, mini biznese të cilat do mbaheshin nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve*
- *të përkrahin zhvillimi i bujqësisë në zonat e fshatrave në të cilat këto komunitete kanë prona*

## 2.5 Shëndetësia dhe çështjet sociale

**Përshkrimi i gjendjes:** Pjesëtarët e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali kanë shërbime të përbashkëta shëndetësore me komunitetet tjera në lokalitetet e tyre. Kryesisht në secilin nga këto lokalitete ka ambulanca në të cilat kryhen shërbimet elementare shëndetësore për të gjithë qytetarët e Kosovës. Për fshatrat Zallq, Veriq, Dobrushë e Banjë ka ambulanca brenda fshatit. Fshatrat tjera nuk kanë ambulancë por shërbimet shëndetësore i marrin në fshatrat fqinje ose në Gurrakoc e Istog.

Se cila është gjendja e vërtetë e komuniteteve në këtë aspekt nuk ka ndonjë hulumtim të saktë por megjithatë ajo që bie në sy është se pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë probleme të theksuara shëndetësore, një pjesë e tyre vdesin shumë të rinj, ka vdekshmëri më të lartë të foshnjave dhe fëmijëve dhe mjaft probleme shëndetësore.

Në lokalitetet ku jetojnë komunitetet rom, egjiptian e ashkali, shtëpitë janë nën nivelin e përgjithshëm të jetesës. Ka pjesëtarë të komunitetit që jetojnë në shtëpi që s'plotësojnë asnjë kusht banimi, furnizimin me ujë të shëndetshëm për disa nuk është i mirë, një pjesë e madhe nuk kanë mundësi të kenë banjo të kompletuara e as kanalizime. Pasi një pjesë e madhe jeton në varfëri të plotë, ata nuk kanë ushqimin adekuat, shumë herë ushqehen edhe me gjëra të gjetura apo të falura që mund të jenë të dëmshme. Të gjitha këto ndikojnë në shëndetin e njeriut dhe në krijimin e sëmundjeve. Një pjesë e fëmijëve lindin jashtë spitaleve, ndërsa foshnjat dhe fëmijët nuk vaksinohen. Kontrollat mjekësore nuk janë të rregullta edhe si pasojë e mungesës së edukatës së duhur shëndetësore të prindërve dhe të gjithë komunitetit.

Sa i përket shërbimeve sociale duhet pasur parasysh se shoqëria kosovare nuk ofron shumë në politikat sociale. Numri i vogël i atyre që përfitojnë këtë ndihmë vjen për shkakun se kriteret për të përfituar janë shumë të vështira dhe të paktë janë ata që mund t'i plotësojnë. Në muajin nëntor 2008 Qendra për punë sociale ka evidentuar gjithsej 712 përfitues në komunën e Istogut. Nga ta së paku 46 familje me 215 anëtarë janë të komuniteteve rom, egjiptian e ashkali, por numri i tyre mendohet se është më i madh për faktin se jo të gjithë e kanë treguar përkatësinë etnike.

Një nga dukuritë më shqetësuese të shoqërisë sot është ai i lypësve të vegjël nga radhët e këtyre komuniteteve. Fëmijë kryesisht të moshave deri në 10 vjeç bredhin rrugëve të



Istogut dhe komunave tjera duke kërkuar lëmshë. Sipas të dhënave që ka komuniteti, aktivistëve të komunitetit dhe përfaqësuesve të tij, në komunë e Istogut këta fëmijë nuk janë nga familjet që jetojnë në të komunë, ata janë sjellë nga komuna tjera për të kërkuar lëmshë, ose ja rrallë edhe nga jashtë Kosovës.

Dukuria si e tillë është shqetësuese për faktin se këta fëmijë kalojnë një pjesë të tillë të fëmijërisë duke u shfrytëzuar nga të rriturit, që në të shumtën e rasteve janë prindërit e tyre, detyrohen të lënë shkollat, bredhin rrugëve të pa veshur, pa përkujdesjen e duhur shëndetësore duke kërkuar lëmshë nëpër rrugë dhe lokale. Për më shumë, një pjesë e prindërve i shfrytëzon këta fëmijë që menjëherë pas lindjes duke i marrë ata në rrugë ku ata kërkojnë lëmshë, ose i mbajtur të shtrirë për orë të tëra foshnjat në trotuarët e rrugës në kushte jonjerëzore për të pritur lëmshën nga kalimtarët. Institucionet qeveritare dhe lokale, bashkë me qendrën për punë sociale dhe policinë duhet të ndërtojë dhe zbatojnë politikat për ndërprerjen e një dukurie të tillë të shfrytëzimit të fëmijëve në një mënyrë kaq çnjerëzore për fëmijët, një pjesë të cilëve që në moshën foshnjore përballet me këtë fat të hidhur njerëzor.

### **Iniciativat ekzistuese:**

Komuna bashkë me donatorë dhe komunitetet gjatë këtyre 5 vjetëve të kaluara ka realizuar dhjetëra projekte infrastrukture për përmirësimin e kushteve të jetës përfshirë rrugët, ujësjellës, kanalizime, etj në të gjitha lokalitetet ku jetojnë komunitetet, që ka ndikuar në kualitetin e jetës në lokalitetet e banuara më komunitetet rom, egjiptian e ashkali.

Ka disa ambulanca në këto fshatra që ofrojnë shërbime shëndetësore për popullatën. Disa nga organizatat joqeveritare kanë zhvilluar aktivitete kryesisht ligjërata dhe kanë shpërndarë materiale propaganduese për përkujdesjen shëndetësore, rëndësinë e higjienës, planifikimin familjar dhe çështje tjera të lidhura me shëndetin.

Policia bashkë edhe me organizatat ndërkombëtare zhvillojnë tërë kohën aksione të largimit nga rruga të fëmijëve që kërkojnë lëmshë, e poashtu punohet me prindërit për të parandaluar shfrytëzimin e fëmijëve të vegjël për lëmshë.

### **Rekomandime për veprime të mëtejme:**

- të bëhet një hulumtim i plotë për gjendjen shëndetësore në këto komunitete
- të shtohen vizitat mjekësore në lokalitetet ku jetojnë komunitetet

- të përcillet gjendja e vaksinimit dhe të bëhet vaksinimi i fëmijëve të pa vaksinuar
- të shpërndahen falas mjete preventive, ilaçe kundër sëmundjeve ngjitëse, materiale propaganduese për vetëdijësimin për rëndësinë e higjienës
- të përkrahen projektet e OJQ-ve dhe komuniteteve që kanë të bëjnë me shëndetin
- të ndërtohen dhe zbatohen politika për ndalimin e vazhdimin të shfrytëzimit të fëmijëve për të kërkuar lëmshë dhe të bëhet largimi i atyre që vijnë nga komuna tjetër në komunën e Istogut

## **2.6 Anti diskriminimi, siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi**

**Përshtkrimi i gjendjes:** Në mungesë të regjistrimit zyrtar të popullsisë nuk dihet numri i saktë i pjesëtarëve të komuniteteve rom, egjiptian e ashkali në komunën e Istogut. Sipas të dhënave që ka UNHCR në komunën e Istogut jetojnë 2248 pjesëtarët këtyre komuniteteve, por shifrat megjithatë ndryshojnë për shkak se kjo popullatë është në lëvizje dhe ndërron vendbanimet, prandaj nuk ka një numër të saktë të këtyre komuniteteve. Ata jetojnë në varfëri me shumë pak të ardhura me pak mundësi punësimi dhe ndërmarrësie private, kryesisht të papërfshirë në jetën shoqërore. Për kohë të gjatë janë përballur me opinion negativ të shoqërisë për shkak të mënyrës së jetës, varfërisë dhe statusit të shoqëror dhe paragjyqime që kanë ardhur nga mungesa e arsimimit, formimit kulturor, jetës nomade dhe kushteve në të cilat kanë jetuar këto komunitete. Me atë pozitë që kanë pasur, dikur ka qenë e pa mendueshme përfshirja e tyre në administratë dhe vende tjera pune. Por sot në pothuaj në të gjitha institucionet ka të punësuar nga këto komunitete. Me gjithë këtë ndryshim në të mirë të këtyre komuniteteve, ata megjithatë kanë kërkesa për më shumë punësim. Pozita e tyre e pabarabartë posaçërisht ndjehet në raport me komunitetet tjera pakicë. Këtu bëhet fjalë për dallim të madh në punësim me komunitetet boshnjake dhe serbe, që janë në numër shumë më të vogël sesa



komunitetet rom, egjiptian e ashkali. Edhe pse numri i boshnjakëve është përgjysmë më i vogël se ai i romëve, egjiptianëve e ashkalive, në punësim në institucione shtetërore ata s'janë të barabartë: jetojnë 1365 boshnjakë në komunën e Istogut (sipas UNHCR) dhe nga ta janë të punësuar 29 në komunë, ndërsa komuniteti rom, egjiptian e ashkali me 2248 pjesëtarë ka vetëm 5 të punësuar në komunë. Dallimi me komunitete tjera pakicë është edhe në procesin e kthimit dhe ndërtimin e shtëpive. Në pesë vjetët e fundit që zhvillohet kthimi në komunën e Istogut nga projekte qeveritare dhe donatorë të jashtëm për serbët janë ndërtuar rreth 310 shtëpi dhe është realizuar kthimi në gjashtë fshatra në komunën e Istogut. Për komunitetet rom, egjiptian e ashkali janë realizuar vetëm dy projekte kthimit në Dubravë e Cërcë me krejt 22 shtëpi. Diskriminimi nganjëherë ndjehet edhe gjatë ofrimit të shërbimeve publike shtetërore nga të punësuarit në këto institucione ose në jetën e përditshme. Ndodh që mjekët nuk e trajtojnë njëjtë pacientin që vjen nga komunitetet shumë herë për shkak të papastërtisë që mund të ketë, ose për shkak të varfërisë ose edhe për shkak se ai nuk i jep para. Ose ka raste psh. kur mësuesit i ndajnë nxënësit romë në banka të veçanta ose kur prindërit nuk duan që fëmija i tyre të rrijë në bankë me fëmijët e romë apo egjiptianë.

Sa i përket përfaqësimit politik komuniteteve rom, egjiptian e ashkali, ata përfaqësohen nga një subjekt politike që kryesisht tubon pjesëtarët e këtyre komuniteteve: Iniciativa e re demokratike e Kosovës (IRDK) që programin e saj e ka angazhimin për gjendjen e komunitetit egjiptian në Kosovë. pasi numri i romëve është i vogël, subjekti politik i këtij komuniteti Partia Rome e Bashkuar e Kosovë (PRBK) nuk ka ndonjë aktivitet. IRDK ka një këshilltar në Kuvendin Komunal të Istogut, vend ky i fituar direkt nga vota qytetare. Komunitetet kanë përfaqësuesit e vet në komitetet e ndryshme të Kuvendit.

Çështja e sigurisë në këtë komunitet është një çështje që nuk paraqet problem. Komuniteti ka sigurinë, shpreh dhe ushtron pa asnjë problem përkatësinë etnike dhe fetare dhe në vitet e fundit nuk ka pasur asnjë incident me përmbajtje ndëretnike. Ky komunitet as në të kaluarën asnjëherë nuk ka pasur probleme në raport me popullatën shqiptare shumicë.

### Iniciativat ekzistuese:

Komuna e Istogut ka punësuar një numër pjesëtarësh të këtyre komuniteteve në tre sektorët e vet buxhetorë: në administratë, arsim e shëndetësi ku punojnë 5 pjesëtarë të këtij komuniteti. 7 tjerë punojnë në Burgun e Dubravës dhe nga një në TMK e polici. Këta të

punësuar edhe pse jo të shumë paraqesin një ndryshim pozitiv në krahasim me të kaluarën. Edhe në arsimin e lartë të Kosovës janë hapur mundësi për regjistrimin e studentëve nga këto komunitete. Përpos garës njëjtë sikur të gjithë studentët tjerë, Universiteti i Prishtinës ndan kuota të caktuara për pjesëtarët e këtyre komuniteteve në secilin nga fakultetet e tij, për të garantuar shkollimin e lartë. Përfaqësimi i pakicave në parlamentin e Kosovës është i paraparë me Kushtetutën e Kosovës. Sipas kushtetutës për komunitetin egjiptian është i ndarë së paku një vend në Parlamentin e Kosovës në të cilin 100 vende deputeti fitohen me vota kurse 20 tjera janë të parapara për pakicat.

Në Kuvendin Komunal të Istogut ka një nënkryetar të Kuvendit Komunal nga komuniteti egjiptian. Kuvendi ka dy komitete që janë të parapara për të trajtuar problemet e pakicave: Komitetin për komunitete dhe Komitetin për ndërmjetësim në të cilat pakicat kanë shumicën e anëtarëve. Ndërsa në kuadër të qeverisë komunale ka dy zyra që merren me komunitetin: Zyra e komuniteteve dhe Zyra për kthim, në të cilat janë të punësuar edhe përfaqësues të komuniteteve. Kuvendi komunal ndan 5.3 përqind të buxhetit të tij vjetor për komunitetet pakicë.

### Rekomandime për veprime të mëtejme:

- në raste të punësimit në baza nacionale të shikohet dhe të kihet për bazë një farë përqindje, në mënyrë që të mos ndodhe një pakicë të favorizohet dhe tjera të lihet pas dore
- n° institucione si KEK, PTK, ujësjellësi dhe higjiena të punësojë pjesëtarë të këtyre komuniteteve
- institucionet arsimore të punojnë me kuadrin në mënyrë që të evitojnë rastet e dallimeve mes nxënësve në klasa
- të vazhdohet me ndarjen e vendeve për përfaqësimin e komuniteteve pakicë në organet komunale dhe qendrore sipas parimit të "diskriminimit pozitiv"

## 2.7 Kultura, mediat dhe informimi

**Përshkrimi i gjendjes:** Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane kanë identitetet e veta kombëtare. Derisa komuniteti rom ka një identitet më të veçantë dhe më të theksuar, komuniteti egjiptian shumëçka e ka përbashkët me komunitetin shumicë shqiptar. Komuniteti egjiptian ka gjuhë të veten amtare gjuhën shqipe, veshjet e njëjta kombëtare dhe flamurin. Komuniteti rom ka gjuhën e vet, veshjet e veta kombëtare dhe flamurin kombëtar rom.

Gjuha rome sipas të dhënave nga studimet dhe historia ka disa shekuj që është përdorur në Kosovë. Ajo është pjesë e kësaj gjuhe që flet ky komunitet në vende tjera të botës. Por në komunën e Istogut, ku ka vetëm disa familje rome, numri më i madh i pjesëtarëve të këtij komuniteti, posaçërisht moshat e reja nuk e njohin fare këtë gjuhë. Në këtë mënyrë ajo pak nga pak po rrezikon të zhduket mes pjesëtarëve të këtij komuniteti, pasi që ajo njihet vetëm nga njerëz të moshës më të vjetër. Për të mbrojtur këtë pjesë të trashëguar të identitetit rom, mësimi i gjuhës rome është një nga interesimet e këtij komuniteti. Kjo do realizohej duke mbajtur kurse me një ose dy orë në javë për mësimin e gjuhës rome. Mësimi si fillim do organizohej për të gjithë të interesuarit, ndërsa do mbulohej me një mësues, që do duhej angazhuar jashtë nga pasi në komunën e Istogut nuk ka asnjë të tillë.

Komunitetet rom, egjiptian e ashkali poashtu kanë trashëgiminë e vet kulturore, folklorin e njohur të këtyre komuniteteve. Ne të kaluarën ka pasur shembuj të mirë të përfaqësimit të artistëve dhe kësaj kulture por në kohën e sotme nuk ka asnjë përpjekje më të vogël për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të kësaj trashëgimie kulturore. Momentalisht nuk ka asnjë institucion, organizatë a shoqatë që do merrej me kulturën e komuniteteve dhe derisa komunitetet tjera gjithnjë marrin fonde, ndihma dhe subvencione për zhvillimin dhe ruajtjen e identitetit të vet kombëtar, këto komunitete nuk kanë përfituar asnjëherë në këtë aspekt as nga fonde qeveritare e as të donatorëve. Në të vërtetë deri më tani as vet komunitetet nuk kanë qenë në gjendje të parashtrijë dhe argumentojnë një kërkesë të tillë. Prandaj krijimi i një lloj organi (SHKA apo qendër të kulturës rome, egjiptiane e ashkali) do të mund të luante rolin e një koordinatori të jetës kulturore. Ky organ mund të motivonte të rinjtë që të mësojnë dhe të mbajnë më tej këtë trashëgimi në të cilën përfshihen këngët, vallet dhe veshjet tradicionale të këtyre komuniteteve.

Sa i përket aspektit të informimit komunitetet rom, egjiptian e ashkali informohen nga mediat që ofrojnë lajme në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e minoriteteve tjera. Nga aspekti gjuhësor kjo nuk paraqet problem për ta, pasi këto komunitete e përdorin edhe vet si gjuhë të parë gjuhën shqipe, por problemi është se në këto medime ka fare pak emisione dhe lajme për jetën dhe gjendjen e këtyre komuniteteve. Momentalisht komunitetet rom, egjiptian e ashkali nuk ka asnjë medium të vetin në rajonin e Pejës. Televizioni publik i Kosovës RTK ka një emision informativ argëtues një herë në javë në gjuhën rome. Komuniteti kërkon një emision në RTK që do transmetonte program një herë në dy javë për komunitetin egjiptian.

Një gazetë lokale që fillimisht mund të botohej një herë apo dy herë në muaj mund të mbulonte poashtu nevojën për informim. Një gazetë e tillë mund të fillonte me një numër të vogël faqesh, dhe do botohej në gjuhën shqipe, gjuhë të cilën e përdorin komunitetet. Por në këto faqe do shkruhej për problemet dhe tematikat e jetës së këtyre komuniteteve. Veç informimit, mediumi për komunitetet rom, egjiptian e ashkali do ndikonte edhe shtimin e lidhjes dhe komunikimin brenda anëtarëve të bashkësisë.

### Iniciativat ekzistuese:

Ne televizionin publik të Kosovës RTK ka një emision javor në gjuhën rome që shërben sadopak në afirmimin e gjuhës dhe kulturës rome. Programi në gjuhën rome poashtu jep edhe informata për jetën e komunitetit dhe zhvillimet që ndodhin në këtë komunitet, ngjarjet me rëndësi dhe zhvillimet duke krijuar një hapësirë lidhje mes romëve në Kosovë. Përfaqësuesit e komuniteteve në kuadër të Këshillit Konsultativ për komunitete kanë paraqitur kërkesat për program në televizionin publik të Kosovës RTK, kushtuar komunitetit egjiptian. Poashtu komuniteti ka një projekt për një studio muzikore dhe një radio multietnike, që nëse gjen përkrahjen financiare do ishte një radio lokale në shërbim të komuniteteve në këtë komunë, Mediat e Kosovës jo rrallë kanë shkruar për këto komunitete dhe projektet që realizohen në hapësirat ku ata jetojnë. Qasja kryesisht është pozitive dhe në funksion të afirmimit të komuniteteve. Për pesë vjet në komunat e rajonit është botuar dhe shpërndarë gazeta e shoqërisë civile "Kasneci". Gazeta çdo numër ka pasur dy faqe kushtuar komunës së Istogut dhe dy faqe kushtuar komuniteteve, në të cilat janë trajtuar edhe problemet më të cilat jeton ky komunitet si dhe është shkruar për aktivitetet që janë zhvilluar. Në web faqen e komunës ka një numër artikujsh për komunitetet dhe aktivitetet të zhvilluara nga aktivistët e komunitetit.

Një grup joformal me emrin "Yjet" që merret me aktivitete artistike, kryesisht muzikë e vallëzim mbledh rreth 60 të rinj të komunitetit. Ata organizojnë disa herë në vit programe artistike, koncerte me këngë e valle që mbahen në Pallatin e kulturës në Istog

### **Rekomandime për veprime të mëtejme:**

- të përkrahet krijimi i një SHKA-je (ose ndonjë organi tjetër kulturor) që do merrej me ruajtjen e trashëgimisë folklorike të komuniteteve rom, ashkali e egjiptase
- ta ndahet buxhet për ruajtjen e trashëgimisë së këtyre komuniteteve ashtu siç jepen fonde komunale dhe qendrore për trashëgiminë kulturore të komuniteteve tjera
- të organizohet kurs mësimi të gjuhës rome
- të ndihmohet hapja e një gazete për komunitetin
- të financohet punësimi i një gazetari në radion lokale për të mbajtur një radio program kushtuar komuniteteve

## **2.8 Të drejtat e femrave**

**Përshkrimi i gjendjes:** Sa i përket pozitës së femrës në komunitetet rom, egjiptian e ashkali nuk ka ndonjë hulumtim të veçantë që e tregon këtë, por ka vend për të dyshuar se pozita e saj është mjaft e vështirë në familje dhe shoqëri. Duke qenë edhe femër edhe pjesëtare e komuniteteve rom, egjiptian e ashkali ajo në një mënyrë përballet me diskriminim të dyfishtë.

Familjet e këtyre komuniteteve zakonisht janë familje patriarkale që funksionojnë në mënyrë të tillë që nuk i japin shumë hapësirë gruas, që shumë herë duke qenë edhe e pashkollë edhe e varfër dhe pa ndonjë mbështetje ekonomike, nuk ka mundësi të luftojë për më shumë të drejta për vendimmarrje në familje. Posaçërisht gjendja është e vështirë për vajzat e këtij komuniteteve, një pjese e mirë e të cilave ndalohen që në moshë shumë të re nga shkolla. Këto vajza që në moshë shumë të vogël detyrohen që të punojnë dhe të mbajnë familjen. Posaçërisht problematike janë rastet e martesave të këtyre femrave që në moshë shumë të re. Ato si të mitura shumë herë martohen pa lejen dhe miratimin e tyre, ndonjëherë edhe duke i shitur për para. Poashtu pas këtyre martesave në moshë të re fillojnë shumë herët lindjen e fëmijëve dhe bëhen nëna në moshë tepër të re. Kjo pastaj

pasohet me shumë lindje gjatë jetës që vijnë nga mungesa e edukatës shëndetësore, planifikimit familjar, etj. dhe që e bëjnë të vështirë jetën e këtyre grave të reja.

### **Iniciativat ekzistuese:**

Organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare kanë mbajtur aktivitete mbi vetëdijesimin e femrave në komunën e Istogut dhe poashtu edhe me femrat e komunitetet rom, shkali e egjiptian.

OJQ "Vizioni 02" ka mbajtur disa aktivitete me interesim për fuqizimin ekonomik të grave të këtij komuniteti. Kurset e rrobaqepësisë, për frizere dhe të tjera të mbajtura nga kjo organizatë i kanë kaluar më se 80 femra të komunitetit që janë aftësuar në profesionet përkatëse. Poashtu femrat e këtij komuniteti kanë marrë pjesë në programe dhe aktivitete tjera argëtuese, muzike e kulturore të organizuara nga organizatë.

### **Rekomandime për veprime të mëtejme:**

- të krijohet sa më shumë hapësirë për shkollimin e femrës në komunitetet rom, egjiptian e ashkali
- ta organizohen kurse për femrat, kurse kundër analfabetizmit, kurse ose aftësime të këtyre femrave në rrobaqepësi, etj.
- të mbahen vizita të vazhdueshme mjekësore në të cilat do flitej për planifikimin familjar
- femrave, posaçërisht vajzave të komuniteteve rom, egjiptian e ashkali t'u tregohen të drejtat e tyre në mënyrë që ato të jenë në gjendje të kundërshtojnë prindërit e tyre lidhur me vendimet që ata marrin sidomos për martesë në moshë të re
- të krijohen mundësi punësimi për femrat përmes përkrahjes së projekteve të femrave në fshatra për punime në qëndisje, punë dore, rrobaqepësi, etj.





# III. Ndërhyrja në komunitet

## 3.1 Hyrje

Kjo pjesë e kësaj strategjie ka të bëjë me qasja nëpër lokalitete të ndryshme, me projekte të veçanta nëpër lagje dhe fshatra të komunës së Istogut. Kryesisht më të shpeshta në këtë pjesë janë projektet për infrastrukturën, projektet e infrastrukturës rrugore, ujësjellësit, kanalizime, bujqësinë, etj.

Në këtë pjesë gjatë hartimit të strategjisë bashkë me komunitetin SiV ka tentuar të bëjë edhe përlllogaritjen e përafërt të kostos së implikimit buxhetor për projektet e veçanta.

Në këtë mënyrë këto kërkesa të komunitetit kanë marrë formën e mini projekteve, në të cilat sipas një modeli të përbashkët janë përcaktuar disa kërkesa si kostoja e përafërt e llogaritur e çmimit, objektivat dhe qëllimet, përfituesit, etj. Këto të dhëna janë konsideruar si pasqyrë e parë për t'u paraqitur para komunës dhe donatorëve për të matur mundësinë e angazhimit financiar.

Zbatimi i këtyre projekteve zbut problemet më të dukshme të komunitetit që bien në sy në shikim të parë në vendet ku jeton, por nuk i zgjodh në përgjithësi problematikat lidhur me komunitetin, prandaj kjo pjesë e tretë e kësaj strategjie duhet parë si shtojcë e pjesës së dytë në të cilin jepen rekomandimet.

Në këtë listë projektesh janë përfshirë dhjetë lokalitetet kryesore, ato fshatra ku kërkesat e komunitetit mund të artikulohen dhe të shprehen para donatorëve.

## 3.2 Fshati Zallq

Fshati Zallq është kryesisht fshat i banuar me komunitetin egjiptian ku e përbejnë shumica e banorëve afërsisht 283 banorë të cilët jetojnë në këtë fshat ndërsa afërsisht 15 familje i takojnë komunitetit shqiptar. Kryesisht banorët e fshatit Zallq gjegjësisht të komunitetit egjiptian kanë qenë të zhvendosur në vendet fqinje, konkretisht në Mal të Zi, por çdo ditë është duke u shtuar numri i të kthyerve në këtë fshat.

Banorët fshatit Zallq jetojnë në kushte të vështira ekonomike ku njëherit është e theksuar problemi i papunësisë në këtë fshat, pasi që shumica e banorëve janë të papunë. Të ardhurat ekzistuese të këtyre familjeve janë kryesisht nga familjarët të cilët gjendet në vendet e ndryshme të Evropës, e një pjesë e tyre edhe nga socialit edhe pse disa njëkohësisht merren edhe me bujqësi edhe pse s'kanë mjete përkatëse për punë.

Banorët e këtij fshati kanë probleme dhe vështirësi të shumta, sidomos nga ato themelore, siç është mungesa e ujit të pijshëm, për shkak se në këtë fshat nuk ka ujësjellës, rrugët janë të dëmtuara.

Titulli i Projektit: Asfaltimi i rrugës Zallq

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja:  
8 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Zallq, Istog

Buxheti: 170.000 €

Qëllimi i projektit:

Përmirësimi i kushteve të jetesës së komunitetit të fshatit Zallq kryesisht fshat ky i banuar me shumicë të komunitetit rom dhe egjiptian. Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për fshatin Zallq ku do të ndërlihej me rrugën që shpi në fshatin Osojan të banuar kryesisht me banorë serbë.

Objektivat:

- Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve të cilët jetojnë dhe për ata të cilët do të kthen
- Vijimi i mësimit me rregull në shkollën fillore nga nxënësit e këtij fshati
- Rritja e besueshmërisë së komuniteteve që jetojnë në këtë fshat

Përfituesit:

Banorët të cilët jetojnë në këtë fshat të cilët janë me shumicë të banuar nga komuniteti rom e egjiptian po një numër i vogël dhe të komunitetit shqiptar. Njëkohësisht përfitues do të jenë edhe komunitetet dhe ato familje të cilat do të kthehen si të zhvendosur nga vendet e tjera të rajonit.

Qasja:

Në kuadër të këtij projekti do të jetë e mundur asfaltimi i rrugës për gjatë fshatit Zallq që lidhet me rrugën nga magjistralja Istog- Klinë, po ashtu edhe me rrugën që lidhet me fshatin Osojan të komunës së Istogut. Rruga në fjalë është shumë e dëmtuar sidomos nga të reshurat atmosferike dhe sidomos gjatë stinës së dimrit qarkullimi i banorëve sidomos i nxënësve është shumë i vështirë për shkak se krijohen shumë përroska të mbushura me baltë. Rruga që do të asfaltohet është në gjatësi prej 2 km dhe gjerësi prej 3 metra. Asfaltimi i kësaj rruge do të jetë zgjedhja më e mirë e problemit të rrugës për këta banorë të këtij fshati.

Titulli i Projektit: Ujësjetësi për fshatin Zallq

Spektori: Infrastruktura

Kohëzgjatja:

9 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Zallq, Istog

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim furnizimin me ujë të pijes për banorët e këtij lokaliteti. Ata nuk janë të përfshirë në projektin e ujësjetësit për disa fshatra që po e realizon komuna e Istogut. I vetmi furnizim me ujë për ta është nga pusët (bunarët), që është ujë i papërshtatshëm për pije dhe bart rreziqe shëndetësore për ata që e konsumojnë. Analizat që ka kryer KFOR-i spanjoll kanë treguar se ky ujë nuk i plotëson kushtet për pije.

Ujësjetësi i ri për banorët përmirëson kushtet e jetës, eviton rrezikun nga sëmundjet, stimulon kthimin dhe integrimin e komunitetit RAE, që e banojnë kryesisht këtë fshat.

Objektivat:

- ? Furnizimi me ujë të pijes për secilën familje në fshat
- Eliminimi i rreziqeve dhe sëmundjeve nga përdorimi i ujit të papastër
- Përmirësimi i kushteve të jetës dhe stimulimi i kthimit për të larguarit
- Rritja dhe thellimi i besueshmërisë ndaj institucioneve dhe ndërmjet vet grupeve etnike që jetojnë në këtë lokalitet

Përfituesit:

Përfitues në këtë projekt janë 270 banorë sa ka momentalisht ky fshat, pjesa më e madhe, mbi 90 % të cilëve i takojnë komunitetit rom e egjiptian.

Qasja:

Ky projekt do realizohej me kyçjen në projektin ekzistues të ujësjetësit për disa fshatra të komunës së Istogut, të cilin po e realizon Komuna. Kyçja do bëhej në këtë ujësjetësi në largësi rreth 2 kilometra larg fshatit në magjistralen Gurrakoc-Klinë. Kanali i ujësjetësit do të kalonte përgjatë rrugës së fshatit me mundësitë e kyçeve anësore për banorët.

### 3.3 Bashkësia Lokale Gurrakoc

Përafërsisht numri i banorëve të bashkësisë lokale të Gurrakoc është 6.500 banorë, megjithëse pas vitit 1999 ka pasur lëvizje të ndryshme të komuniteteve si p.sh: komunitetet egjiptian, rom, boshnjak dhe serb të kësaj bashkësie lokale. Mundësia për të krijuar një jetë funksionale është e vështirë që të arrihet pasi që dihet edhe gjendja e vështirë e këtyre komuniteteve si në aspektin social-ekonomike dhe në atë të nivelit të ulët të arsimit. Puna me këtë komunitet është më se e nevojshme në mënyrë që sadopak të krijohen mundësi që në vete këta njerëz të krijojnë bindje se kjo situatë do të mund të ndryshonte. Duhet të punohet në ndryshimin e kësaj gjendje, pra në zbutjen e varshmërisë dhe papunësisë për të gjitha komunitetet të cilat jetojnë në Gurrakoc. Bashkësia lokale Gurrakoc është etnikisht e përzier (shqiptarë, romë, egjiptianë, boshnjakë dhe serbë të cilët janë kthyer vitet e fundit).

Është shumë mirë i njohur fakti se njerëzit e komuniteteve në fjalë kanë trashëguar prapambetjen në shoqëri përgjithësisht e veçanërisht në sferat më vitale si: arsimimi, gjendja ekonomike edhe sociale si dhe sfera tjera që kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të këtyre komuniteteve.

Numri i banorëve të komunitetit egjiptian në Gurrakoc të cilët merren me punimin e tokës është i konsiderueshëm dhe që kanë tokë prej 1 hektarë e më shumë të cilët nuk i posedojnë mjetet të cilat ju nevojiten për punë, andaj gjendja ekonomike e kësaj popullate është shumë e dobët, ngase asnjë banor nuk është i punësuar dhe standardi i jetës është i ulët. Disa prej tyre janë të varur nga ndihma sociale, por punët e bujqësisë dhe kultivimit të bimëve zakonisht i kryejnë gjatë sezonit pranveror. Ata janë të varur dhe presin ndihmë nga ndonjë i afërm (që t'ju ndihmojnë pra me vegla pune e punimin e tokave).

Burimet kryesore të ardhurave në këto lagje janë nga bujqësia, pasi që banoret posedojnë tokat e tyre, po ashtu në Gurrakoc ekzistojnë disa dyqane të vogla ku njerëzit e këtyre fshatrave furnizohen me gjëra ushqimore dhe po ashtu ekziston edhe shtëpia e shëndetit.

Titulli i Projektit:  
Vendosja e trafo-stacionit të ri

Spektori: Infrastruktura

Kohëzgjatja:  
1 vit (Duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gurrakoc, Istog

Buxheti: 25.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim furnizimin më të mirë me rrymë elektrike për banorët e këtij lokaliteti. Banorët e Gurrakocit kanë probleme me furnizimin me rrymë elektrike. Edhe pse zona ka rreth 40 familje ata furnizohen nga një trafo e përbashkët që ndodhet në qendër të Gurrakocit. Kjo bën që furnizimi me rrymë në këtë lagje të jetë i dobët, me tension të ultë dhe prishje të shpeshta për shkak të mbingarkesës që ka trafotja ekzistuese. Të shpeshta janë edhe rastet e prishjes së pajisjeve shtëpiake për shkak të furnizimit jo të rregullt me rrymë, dëme të cilat nuk i kompenson askush. Një trafo e re do të zgjidhte këtë problem për komunitetin e kësaj lagjeje.

Objektivat:

- ? Furnizimi me rrymë elektrike për banorët e kësaj zone
- Evitimi i rreziqeve dhe dëmeve të shkaktuara nga rrjeti ekzistues
- Lehtësimi i mirëmbajtjes së rrjetit furnizues me rrymë

Përfituesit:

Të gjithë banorët e Gurrakocit për shkak se do kenë furnizim më të mirë. Përfitues është edhe KEK-u, për shkak se furnizimi dhe mirëmbajtja do bëhet më lehtë, e kjo do ndikonte që të rritet edhe pagesa e rrymës

Qasja:

Me këtë projekt një trafostacion i ri do ndërtohej në këtë lagje. Trafostacioni do ndërtohej në lagjen Gurrakoc dhe në të do kyçeshin 40 familje. Përveç se rrjeti aktual ekzistues do lehtësohej nga ngarkesa, banorët në zonën e trafos së re do kishin kyçje më të mirë në rrjet, ndërsa trafostacioni aktual do lirohej nga një ngarkesë e tepërt. Përmirësimi i furnizimit do ndikonte edhe në përmirësimin e pagesës së rrymës elektrike.



Titulli i Projektit: Furnizimi i komunitetit me pajisje për zhvillimin e bujqësisë në Gurrakoc

Sektori: Zhvillim ekonomik

Kohëzgjatja:  
1 Vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gurrakoc, Istog

Buxheti: 60 000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për synim të ndihmojë banorët e këtij fshati në punimin e tokës duke iu ofruar atyre lehtësime në mbjelljen e arave. Kjo do të ndikoj edhe në zhvillimin e bujqësisë në zonat rurale si dhe do të ndikojë edhe në përmirësimin e gjendjes ekonomike për komunitetin rom dhe egjiptian të këtij vendi.

Objektivat:

- Sigurimi i pajisjeve kolektive për zhvillimin e bujqësisë
- Organizimi i këtij komuniteti për t'u marrë më zhvillimin e bujqësisë
- Përmirësim e gjendjes ekonomike duke krijuar të ardhura nga kulturat bujqësore
- Lehtësim në përpunimin e fushës sa i përket makinerisë punuese

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e komunitetit rom dhe egjiptian, pasi ata nuk kanë makineri për përpunimin e tokës, edhe pse shumica e banorëve posedojnë tokë bujqësore. Me ofrimin e makinerisë për përpunim të tokës ata do të arrijnë që tokat e tyre t'i mbjellin me kultura të ndryshme bujqësore, që do të mund t'i plasojnë në treg dhe nga kjo të krijojnë të ardhura për familjet e tyre.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të blihet traktorë me të gjitha pajisjet tjera të nevojshme për bujqësi. Këto pajisje bujqësore do të jenë në shfrytëzim të të gjithë banorëve. Do të përzgjidhet disa persona të cilët do të përkujdesen për mirëmbajtjen e makinerisë si dhe do të koordinojnë punën e bujqve rreth përpunimit të tokës.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i Qendrës për komunitete në Gurrakoc

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja:  
2 Vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gurrakoc, Istog

Buxheti: 130.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të ofrojë kushte më të mira për komunitetet rom dhe egjiptian, si dhe të avancojë të rinjtë e këtij komuniteti në fushën e informatikës dhe gjuhëve të huaja përmes mbajtjes së kurseve. Projekti bën integrimin e këtij komuniteti në shoqëri si dhe zhvillon njohuritë e tyre mbi teknologjinë informatike.

Objektivat:

- ? Hapja e qendresë për komunitete dhe fuqizimi i të rinjve të komuniteteve
- Fuqizimi i të rinjve të komuniteteve dhe vetëdijesimi i tyre përmes teknologjisë informatike
- Ofrimi i hapësirës që komunitetet të kenë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë komuniteti rom dhe egjiptian, po ashtu përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e të gjitha fshatrave të komunës së Istogut, të cilët do të kenë mundësinë e shfrytëzimit të kësaj qendre. Përfitues të veçantë do të jenë të rinjtë e komuniteteve pasi që do të kenë mundësinë e vetëdijesimit mbi teknologjinë informative përmes kurseve të ndryshme dhe në të ardhmen të rinjtë e këtyre fshatrave do të kenë më lehtë të qasen në shoqëri dhe të kenë më shumë potencial për të gjetur një vend pune.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të hapet qendra e komuniteteve në qendër të Gurrakocit me qëllim të përfshirjes së të gjitha fshatrave të tjera pasi që Gurrakoci është vendi më i përshtatshëm për t'u kyçur të gjitha fshatrat. Po ashtu kjo qendër do të pajiset me të gjitha mjetet për funksionimin adekuat. Kjo qendër do të shfrytëzohet nga të gjitha grup moshat. Komuniteti do të fuqizohet përmes kurseve dhe trajnimeve që do të mbahet në kuadër të kësaj qendre, do të vetëdijesohen se si duhet qasur institucioneve të ndryshme komunale në lidhje me nevojat dhe hallet e tyre të ndryshme me të cilat ata ballafaqohen dhe nuk dinë se kujt duhet t'i drejtohen.

Titulli i Projektit:  
Rregullimi i rrugës Gurrakoc - Tomoc

Sektori: Infrastruktura

Kohëzgjatja:  
6 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gurrakoc, Istog

Buxheti: 10.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukture për fshatrat Gurrakoc, përmes rregullimit të rrugës që lidhe dy fshatrat Gurakoc dhe Tomoc. Projekti ndihmon edhe në përmirësimin e kushteve të jetës për të gjithë banorët e këtyre dy fshatrave ku jetojnë komunitetet rom, egjiptian dhe shqiptar.

Objektivat:

- Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve të kësaj zone dhe të fshatrave përreth
- Vijimi i mësimin me rregull në shkollën fillore nga nxënësit e këtyre fshatrave
- Ngritja e nivelit të sigurisë për nxënësit në trafik
- Evitimi i rreziqeve dhe dëmeve të shkaktuara nga reshjet atmosferike dhe lumit, i cili gjendet afër kësaj rruge

Përfituesit:

Të gjithë banorët e Gurrakocit dhe fshatit Tomoc, nxënësit e këtyre fshatrave si dhe të gjithë banorët e fshatrave përreth.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të shtrohet rruga që ndërlidh dy fshatra mes veti. Rruga do të shtrohet me zhavorr për të ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetës së banorëve të këtij fshati si dhe fshatrave përreth. Rruga do të shtrohet në gjatësi prej 1 kilometër dhe gjerësi prej 3 metra. Për shkak të kushteve ekonomike banorët e këtij fshati nuk kanë mundësinë e ndihmës financiare për ta realizuar këtë projekt, mirëpo do të ndihmojnë gjatë gjithë kohës për realizimin e këtij projekti dhe shtruarjen e kësaj rruge.

Titulli i Projektit: Vendosja e kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave

Sektori: Shëndetësi dhe Ambient

Kohëzgjatja:  
4 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gurrakoc, Istog

Buxheti: 6.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për synim të krijojë një ambient më të pastër në fshat, si dhe të mbrojë shëndetin e banorëve të këtij fshati, të vetëdijesojë banorët në mirëmbajtjen e ambientit në vendin ku jetojnë.

Objektivat:

- ? Vendosja e kontejnerëve për mbeturina
- Krijojmë i një shoqëri më të shëndoshë dhe më të pastër përmes ruajtjes së ambientit dhe pastërtisë
- Pastrimi i deponive ilegale më mbeturina
- Ofrim i shërbimeve më të mira për mirëmbajtje të ambientit

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit Gurakoc, të të gjitha komuniteteve, pasi që me vendosjen e kontejnerëve në fshat do të rritet niveli i pastërtisë në fshat. Kjo ofron kushte më të mira për të jetuar aty, e në veçanti shëndet më të sigurt, pasi me vendosjen e kontejnerëve do të largohen mbeturinat nga rrugët e fshatit dhe deponitë ilegale.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të vendosen 15 kontejner, nëpër lagje të ndryshme, do të pastrohen vendet ilegale nga mbeturinat që janë krijuar nga vetë banorët e fshatit. Do të angazhohet kompania për shërbime publike që të ju ofroj shërbim çdo javor për pastrimin e kontejnerëve dhe largimin e mbeturinave.

Titulli i Projektit: Profesionalizimi i komunitetit përmes kurseve profesionale

Sektori: Të drejtat e femrave

Kohëzgjatja:  
12 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gurrakoc, Istog

Buxheti: 10.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim profesionalizimin e grupit të komunitetit të grave egjiptiane përmes kurseve profesionale mbi lëmin e rrobaqepësisë dhe floktarisë.

Objektivat:

- ? Profesionalizimi i grave përmes kurseve adekuate profesionale të rrobaqepësisë dhe floktarisë
- Vetëdijesimi i komunitetit mbi përcaktimin e profesionit të tyre
- Ngritja e kapaciteteve të komuniteteve përmes kurseve dhe trajnimeve të ndryshme mbi lëmin e rrobaqepësisë dhe floktarisë

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë grupi i grave dhe të rejave, të cilët i takojnë moshës nga 18 40 vjeçare. Përfitues në këtë projekt do të jenë edhe gratë e komuniteteve shqiptar, egjiptian dhe rom nga fshatrat e tjera përreth, pasi që nevoja për këto kurse është e shumë fshatrave.

Qasja:

Sipas këtij projekti për realizimin e këtyre kurseve profesionale, të cilat ndikojnë shumë pozitivisht në komunitetet, do të shfrytëzohen objektet private. Është menduar që kurset të mbahen në dy grupe të veçanta me orar të ndryshëm. Njëherit duhet të investohet edhe në krijimin e kushteve për realizimin e këtyre kurseve duke u pajisur me makina qepëse dhe materiale të ndryshme të cilat do të nevojiten për të kryer këto kurse.

### 3.4 Fshatrat Drejë e Oprashkë

Dreja dhe Oprashka janë dy fshatra fqinje që gjenden në anën e djathtë në kilometrin e dhjetë të rrugës Gurrakoc Klinë. Fshatrat janë të banuara kryesisht me banorë të komunitetit egjiptian dhe shqiptar. Banorët e këtyre fshatrave janë marrë dhe vazhdojnë të merren më shumë aktivitete bujqësore edhe pse për të zhvilluar këto aktivitete kushtet nuk janë edhe aq të mira. Toka është pjellore dhe mund të ketë produkte të ndryshme dhe një përfitim të mirë nga bujqësia, mirëpo mungesa e pajisjeve bujqësore i vështirëson këto aktivitete.

Nga përafërsisht 500 banorë sa numërojnë fshatrat Drejë dhe Oprashkë vetëm 10-12 persona janë të punësuar dhe pagat e tyre sigurohen nga buxheti i Kosovës ndërsa 12 familje marrin ndihmë sociale. Për të rinjtë e këtyre fshatrave të cilët janë afër 70 % mbetet joshës emigrimi në Perëndim pasi që këtu nuk shohin asnjë perspektivë.

Këto dy fshatra ballafaqohen me vështirësi për shkak të mungesës së ujit të pijes, kanalizimit për ujera të zeza, kontejnerëve për mbeturina dhe rruga. Banorë nuk furnizohen me ujë të pijes nga sistemi i ujësjellësit, por si alternativë i kanë puset e ujit të cilat asnjëherë nuk kontrollohen.

Rruga e këtyre fshatrave është në gjendje të mjerueshme. Pasojat e kësaj më së shumti i bartin fëmijët e këtyre fshatarëve, ngase ata duhet që të kalojnë çdo ditë për të shkuar në shkollë në një fshat tjetër, pasi që në këto dy fshatra nuk ka shkollë fillore. Aty nuk ka as ambulante për të kryer shërbimet mjekësore dhe qytetarët duhet që të gjitha shërbimet t'i kryejnë në fshatin Zallq.

Titulli i Projektit:  
Rregullimi i rrugës Drejë-Zallq

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja:  
4 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Drejë, Istog

Buxheti: 12.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për fshatrat Drejë dhe Zallq, përmes rregullimit të rrugës që lidhe dy fshatrat Drejë dhe Zallq. Projekti ndihmon edhe në përmirësimin e kushteve të jetës për të gjithë banorët e këtyre dy fshatrave, ku jetojnë komunitetet rom, egjiptian dhe shqiptar.

Objektivat:

- ? Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve të kësaj zone dhe të fshatrave përreth
- Vijimi i mësimit me rregull në shkollën fillore nga nxënësit e këtyre fshatrave
- Ngritja e nivelit të sigurisë për nxënësit në trafik
- Lidhjen e fshatrave tjera me këtë fshat si dhe lidhja me qendrat Istog dhe Klinë

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit Drejë, nxënësit e këtij fshati si dhe të gjithë banorët e fshatrave përreth si: Oprashka, Zallqi, Koshi, Leskoci e Shalinovci.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të shtrohet rruga që ndërlidh disa fshatra mes veti si dhe qendrat Klinë dhe Istog. Rruga do të shtrohet me zhavorr për të ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetës së banorëve të këtij fshati si dhe fshatrave përreth njëherit rruga do të shtrohet në gjatësi prej 3 kilometra dhe gjerësi prej 3 metra, njëherit për shkak të kushteve ekonomike banorët e këtij fshati nuk kanë mundësinë e ndihmës financiare për ta realizuar këtë projekt, mirëpo do të ndihmojnë gjatë gjithë kohës për realizimin e këtij Projekti dhe shtruarjen e kësaj rruge si ndër prioritetet e këtij komuniteti në këtë fshat.

Titulli i Projektit: Rregullimi i kanalizimit për fshatin Drejë - Oprashkë

Sektori : Infrastrukturë

Kohëzgjatja:  
1 Vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Drejë-Oprashkë, Istog

Buxheti: 80.000 €

Qëllimi i projektit:

Të ofrojë kushte më të mira për banorët egjiptianë si dhe ata shqiptarë, si dhe të zgjidh problemin e ujërave të zeza dhe ujërave fekale. Fshatit i mungon një kanalizim kolektiv ku do të mund të derdheshin ujërat e zeza, si dhe do të kyçte të gjitha familjet në kanalizimin e fshatit, gjë që do të ndikojë në ruajtjen e shëndetit të banorëve.

Objektivat:

- Krijimi i kushteve më të mira për jetë të komunitetit me rregullimin e kanalizimit të fshatrave Drejë-Oprashkë
- Kyçja e të gjitha shtëpive në rrjetin e kanalizimit
- Mbrojtja e shëndetit të banorëve nga kundërmimi i ujërave të zeza

Përfituesit:

Banoret e fshatrave Drejë dhe Oprashkë pasi ende nuk e kanë të zgjidhur problemin e kanalizimit. Po ashtu me kanalizimin ujërave të zeza do të mbrohet edhe shëndeti i banorëve e në veçanti shëndeti i fëmijëve nga infektimet e mundshme nga kundërmimi i ujërave të zeza.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të fillojë hapja e kanalizimit në fillim të fshatit dhe do të vazhdojë drejt fshatit Oprashkë. Gjatësia e kanalizimit do të jetë diku 2 km dhe do të shtrihet në të gjitha pjesët e fshatrave.

Titulli i Projektit:  
Sigurimi i transportit për nxënës

Sektori: Edukim, Siguri

Kohëzgjatja:  
24 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Drejë-Oprashkë, Istog

Buxheti: 15.400 €

Qëllimi i projektit:

Projekt do të ju ofrojë kushte më të mira për shkollim nxënësve, të fshatit Oprashkë dhe Drejë, të cilët çdo ditë duhet të udhëtojnë mbi 4 km në këmbë për të vijuar mësimin në shkollën fillore, e cila ndodhet në fshatin Zallq.

Objektivat:

- ? Sigurimi i një autobusi
- Rritja e numrit të nxënësve për shkollim nga këto fshatra
- Vijimi i mësimin më rregull i nxënësve të këtyre fshatrave

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit Oprashkë dhe Drejë, e veçanërisht, fëmijët të cilët vijnë në shkollimin fillore në fshatin Zallq. Më sigurimin e transportit të këtyre fëmijëve do të rritet edhe siguria e nxënësve për të shkuar në shkollë si dhe do të rritet edhe numri i fëmijëve parashkollorë.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të sigurohet një autobus ose kombi-bus, i cili do t'i bart nxënësit e këtyre dy fshatrave nga fshatrat për në shkollë. Ky autobus do të ketë katër linja në ditë, në ndërrimin e paradites dhe pas ditës.

Titulli i Projektit:  
Ndërtimi i Trafostacionit të ri

Spektori: Infrastruktura

Kohëzgjatja:  
10 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Drejë, Istog

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për synim furnizimin sa më të mirë ta banorëve më rrymë elektrike, duke ju ofruar një jetë normale pasi trafoja në të cilën është i kyçur fshati ndodhet larg.

Objektivat:

- Furnizim me rrymë më kualitative për banorët e fshatit
- Kushte më të mira për hapjen e ndonjë biznesi
- Evitimi i rreziqeve dhe dëmeve të shkaktuara nga rrjeti ekzistues

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit të cilët do të furnizohen me rrymë elektrike, përfitues të veçantë do të jenë 25 familje të fshatit Drejë, të komunitetit egjiptian dhe atij shqiptar. Përfitues do të jenë edhe bizneset, sepse u ofrohen kushte më të favorshme për investuar në këtë fshat apo për të hapur ndonjë mini-fabrikë apo biznes.

Qasja:

Në qendër të fshatit Drejë do të ndërtohet trafostacioni, ku do të kenë mundësinë e kycjes 25 familje nga fshati Drejë, pasi që këto familje kanë probleme të shumta me furnizimin e rrymës elektrike. Me ndërtimin e trafostacionit këto familje do të kenë më të lehtë kryerjen e shërbimeve ndaj KEK-ut.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i kooperativës Bujqësore në fshatin Drejë

Spektori: Zhvillim ekonomik, Punësim

Kohëzgjatja:  
16 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Drejë-Oprashkë Istog

Buxheti: 160.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të ndikojë në zhvillimin e bujqësisë si dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike përmes investimeve në bujqësi.

Objektivat:

- ? Zhvillim ekonomik përmes bujqësisë
- Hapja e vendeve të reja të punës
- Mbështetje e bujqve më makineri për përpunimin e tokës
- Pajisja e kooperativës me mjete bujqësore

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit Drejë, Oprashkë dhe Zallq ku do të jenë të përfshira të gjitha komunitetet që jetojnë në këto fshatra, e në veçanti komuniteti egjiptian dhe rom pasi që këto komunitete nuk posedojnë mjete për përpunimin e tokave bujqësore. Po ashtu kjo do të ndikojë edhe në lehtësim për ta punuar tokën, dhe do të ngrit edhe prodhimtarin e fshatit me kultura të ndryshme bujqësore, sidomos perimtarinë.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të ndërtohet një objekt 250 metra katror në qendër të fshatit. Objekti mendohet të pajiset me të gjitha mjetet e punës për bujqësi, njëkohësisht do të ketë edhe një zyre për koordinatoren e kooperativës, si dhe banje në mënyrë që tu ofrohen kushte më të mira për punë brenda kooperativës.

Titulli i Projektit: Riparimi i rrjetit elektrik

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja:

9 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Oprashkë, Istog

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për synim furnizimin sa më të mirë të banorëve me rrymë elektrike për të ofruar jetë normale.

Objektivat:

- ? Furnizim me rrymë më kualitative për banorët e fshatit
- Riparimi i rrjetit elektrik dhe përmirësimi i furnizimit me rrymë
- Evitimi i rreziqeve dhe dëmeve të shkaktuara nga rrjeti ekzistues

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit të cilët do të furnizohen me rrymë elektrike, pasi që për momentin furnizimi me rrymë elektrike është shumë i dobët.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të riparohet rrjeti elektrik i cili për momentin është shumë i dëmtuar dhe banorët nuk kanë mundësinë e furnizimit të kënaqshëm me rrymë elektrike. Po ashtu rrjeti aktual krijon edhe rrezikshmëri për banorët e fshatit. Rrjeti i ri elektrik për fshatin Oprashkë do të jetë në gjatësinë prej 1. km. Me ndërtimin e trafostacionit këto familje do të kenë më të lehtë kryerjen e shërbimeve ndaj KEK-ut.

### 3.5 Fshati Cërcë

Fshati Cërcë ndodhet në një largësi prej 3 km nga qyteti, dhe shtrihet në pjesën jugore të qytetit, afër magjistrales Istog Vrellë. Në këtë fshat jetojnë mbi 100 familje dhe së prej tyre 15 familje janë egjiptiane me 52 banorë, banorët e këtushëm kryesisht merren me bujqësi, si i vetmi burim i të ardhurave për familjet e tyre.

Komuniteti egjiptian jeton në një gjendje të rendë ekonomike dhe së pjesa më e madhe e familjeve jetojnë nga asistenca sociale.

Në fshat mungon ambulanca për të ofruar shërbimet mjekësore më afër, dhe në mungesë të saj banorët e këtij fshati të gjitha shërbimet mjekësori i kryejnë në Shtëpinë e shëndetit në Istog dhe në qendrën e mjekësisë familjare në Vrellë.

Fëmijët e këtij komuniteti vijojnë mësimin fillor në shkollat fillore në Istog dhe në Vrellë, ndërsa shkollimin e mesëm në Istog dhe në Gurrakoc. Në këtë fshat mungojnë edhe qendrat rekreative për t'u mundësuar të rinjve të këtij fshati që të merren më ndonjë aktivitet.

Titulli i Projektit: Ngritja e nivelit të diturisë

Sektori: Edukim Rini

Kohëzgjatja:

1 Vit (duke filluar nga Viti 2009)

Vendi: Cërcë-Trushevinë, Istog

Buxheti: 90.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për synim të fuqizojë dhe përkrah grupet e grave dhe të rinjve të fshatrave Cërcë dhe Trushevinë përmes kurseve dhe trajnimeve të ndryshme mbi gjuhët e huaja si dhe kurset për floktari, rrobaqepësi si dhe kurset mbi njohurit elementare mbi kompjuter.

Objektivat:

- ? Ndërtimi i qendrës së komuniteteve dhe mundësia e funksionimit përmes aktiviteteve të ndryshme
- Aftësimi i grupit të grave të komuniteteve mbi kurset dhe trajnimet në lëmin e floktarisë dhe rrobaqepësisë si dhe të kompjuterëve në kuadër të Qendrës
- Aftësimi i të rinjve mbi gjuhët e huaja dhe kompjuterikes

Përfituesit:

Të rinjtë dhe gratë e fshatrave Trushovinë dhe Cërcë të cilët do të jenë përfitues të këtyre aktivisteve në kuadër të qendrës së komuniteteve.

Qasja:

Ky projekt do të fokusohet në ndërtimin e një qendre të komuniteteve, që shihet si shumë e nevojshme për komunitetet në këto dy fshatra. Në kuadër të kësaj qendre planifikohet që të realizohet shumë aktivitete për gratë e të rinjtë, siç janë realizimi i kurseve të gjuhës angleze, kursit të kompjuterëve si dhe kurset për grupet e grave si për floktari dhe rrobaqepësi.

Ideja e këtij projekti ka dalë si nevojë e komunitetit pasi që në këto fshatra ka mungesë të aktiviteteve dhe njohurive të përgjithshme sidomos në gjuhën angleze, kompjuter si dhe floktari e rrobaqepësi, etj. Në periudhën afatgjatë kjo qendër mendohet të ndihmojë edhe në zbutjen e papunësisë sepse pretendohet që pas përfundimit të kurseve të floktarisë dhe rrobaqepësisë, të hapen edhe sallone për floktari dhe rrobaqepësi. Aty do të ofroreshin shërbime me pagesë për njerëzit të cilët jetojnë nëpër këto fshatra si në floktari po ashtu edhe në rrobaqepësi, ku njëherit do të ndihmonin edhe në qëndrueshmërinë e qendrës së komuniteteve.



Titulli i Projektit: Asfaltimi i rrugës Cërcë-Trushevinë

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja:  
10 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Cërcë-Trushevinë, Istog

Buxheti: 250.000 €

Qëllimi i projektit:

Përmirësimi i kushteve të jetesës së komunitetit të fshatit Cërcë dhe Trushevinë, kryesisht fshatra këto të banuara me shumicë të komunitetit egjiptian. Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për fshatrat Cërcë dhe Trushevinë ku do të ndërliidhej me rrugën që shpie me qendrën e Istogut.

Objektivat:

- Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve të cilët jetojnë ne fshatrat Cërcë dhe Trushevinë
- Lehtësimi i kushteve për vijimin në shkollën fillore dhe të mesme nga nxënësit e këtyre fshatrave
- Rritja e besueshmërisë së komuniteteve që jetojnë në këto fshatra.
- Lidhjen e fshatrave tjera si dhe lidhja me qendrën e Istogut

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatrave Cërcë dhe Trushevinë, nxënësit e këtyre fshatrave si dhe të gjithë banorët e fshatrave për rreth.

Qasja:

Në kuadër të këtij projekti do të jetë e mundur asfaltimi i rrugës për gjatë fshatrave Cërcë dhe Trushevinë, që njëherit lidhet me rrugën e Istogut. Rruga në fjalë është shumë e dëmtuar sidomos nga të reshurat atmosferike dhe sidomos gjatë stinës së dimrit, qarkullimi i banorëve sidomos nxënësve është shumë i vështirë për shkak se krijohen shumë proçka të mbushura me baltë. Rruga që do të asfaltohet është në gjatësinë prej 2.5 km dhe gjerësinë prej 5 metra, asfaltimi i kësaj rruge do të jetë zgjedhja më e mirë e problemit të rrugës për këta banorë të këtyre fshatrave.

Titulli i Projektit:  
Ndërtimi i mini fermës dhe fuqizimi i saj

Sektori: Zhvillim Ekonomik dhe Punësim

Kohëzgjatja:  
3 Vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Cërcë, Trushevinë, Istog

Buxheti: 100.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të ndikojë në zhvillimin e blegtorisë si dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike përmes investimeve në blegtori

Objektivat:

- ? Zhvillim ekonomik përmes blegtorisë
- Hapja e vendeve të reja të punës
- Mbështetje blegtorëve të fshatit dhe fuqizimi i tyre

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit Cërcë dhe Trushevinë të gjitha komuniteteve, e në veçanti përfituesit më të mëdhenj komuniteti egjiptian.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të ndërtohej një objekt 450 metra katrore, objekti mendohet të ketë një garazh prej 40 metra katrore ku do të vendoset makineria e punës, si dhe një zyre për koordinatorin e kooperativës në një hapësirë prej 12 metra katrore si dhe një banjë prej 6 metra katrore, që të ju ofrojë kushte më të mira për punë brenda mini fermës. Njëkohësisht nevojitet që në kuadër të kësaj ferme duhet të blihen edhe 20 krerë lopë dhe 10 krerë viça. Po ashtu nevojitet edhe një traktor me të gjitha pajisjet për lehtësimin e punës për mini fermën. Njëkohësisht qumështi do të bartet tek pikat e duhura ku do të shitet në mënyrë që të krijohen të ardhura për banorët dhe mirëmbajtjen e mini fermës.

### 3.6 Fshati Kovragë

Fshati Kovragë është kryesisht fshat i banuar me komunitetet egjiptian, shqiptar, boshnjak dhe serb, ku jetojnë afërsisht 200 familje të komuniteteve të përziera.

Problematikat më të cilët përballet ky fshat janë të shumta, papunësia është e theksuar në shkallen më të lartë, banorët jetojnë nga bujqësia primitive si dhe nga ndihmat sociale. Infrastruktura në këtë fshat është në nivelin më të dobët, si rrugët e dëmtuara dhe shumë probleme të tjera me të cilat ballafaqohen banorët e fshatit Kovragë.

Po ashtu fshati Kovragë edhe problemet me edukim dhe shëndetësi pasi që në fshat nuk ekzistojnë as objekti shkollor por as edhe ambulanca. Komuniteti do të kishte mundësinë e kryerjes së shërbimeve brenda fshatit. Fshati Kovragë shërbimet mjekësore i kryen në Istog që është larg 10 km. Ndërsa për një pjesë të fshatit është problem edhe shkollimi për arsye se është shumë larg objekti shkollor, afërsisht 3 km larg fshatit pasi që nxënësit duhet të vijnë në mesimin në fshatin Llukafç i Thatë.

Titulli i Projektit: Asfaltimi i rrugës Kovragë

Sektori: Infrastruktura

Kohëzgjatja:

13 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Kovragë, Istog

Buxheti: 80.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për fshatin Kovragë ku kjo rrugë do të jepte mundësi banorëve të kenë një qasje më të mirë në Gurakoc.

Objektivat:

- ? Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve të cilët jetojnë në këtë fshat
- Krijimi i kushteve më të mira për mesimin të rregullt në shkollën fillore nga nxënësit e këtij fshati
- Evitimi i rrezikut nga trafiku për nxënësit e fshatit

Përfituesit:

Të gjithë banorët që jetojnë në këtë fshat duke përfshirë edhe komunitetin shqiptar, të cilët jetojnë në këtë fshat. Përfituesit direkt do të jenë edhe komunitetet rom e egjiptian, të cilët jetojnë në këtë fshat, e po ashtu edhe nxënësit e shkollës fillore të cilët gravitojnë në këtë shkollë.

Qasja:

Në kuadër të këtij projekti do të jetë e mundur asfaltimi i rrugës në brendësi të fshati ku rruga është shumë e dëmtuar dhe nuk ka kushte të mira për lëvizje në këtë rrugë sidomos gjatë stinëve vjeshtë dhe dimër pasi që krijohen shumë proçka me balte dhe ujëra të mëdha duke pamundësuar edhe kryerjen e punëve bujqësore. Rruga që do të asfaltohet është në gjatësinë prej 1 km dhe gjerësinë prej 3 metra, asfaltimi i kësaj rruge do të jetë zgjedhja më e mirë e problemit të rrugës dhe banorëve të këtij fshati.

Titulli i Projektit: Vizitat mjekësore për banorët e fshatit Kovragë

Sektori: Shëndetësi

Kohëzgjatja:  
1 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Kovragë, Istog

Buxheti: 10.000

Qëllimi i projektit:

Organizimi i vizitave nga mjekët tek banorët e fshatit Kovragë në veçanti për personat e shtyrë në moshë.

Objektivat:

- ? Ngritja e kualitetit të ofrimit shërbimeve mjekësore.
- Përkujdesja adekuatë për banorët e fshatit në veçanti për ata të moshuarit
- Krijimi i kushteve më të mira si dhe integrimi më i mirë i komuniteteve egjiptian dhe rom në shoqëri
- Ngritja e nivelit të sigurimit shëndetësor në vendet rurale për të gjithë

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e fshatit Kovragë, me theks të veçantë personat të cilat janë të shtyrë në moshë dhe nuk kanë përkujdesje të nevojshme familjare.

Qasja:

Organizimi i vizitave mjekësore në fshat çdo javë nga mjekët specialistë për të gjithë banorët e fshatit të cilët kanë nevojë për mjekim, me qëllim ngritjen e kualitetit dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore së banorëve të fshatit, si dhe qasjen e komunitetit në institucione për shfrytëzimin e të drejtës dhe realizimin e nevojave të tyre.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i nënkalimit në fshatin Kovragë

Sektori: Siguria

Kohëzgjatja:  
2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Kovragë, Istog

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të krijojë siguri për të gjithë banorët në veçanti për nxënësit e shkollës fillore, duke ndërtuar nënkalimin në rrugën magjistrale Gurrakoc-Mitrovicë.

Objektivat:

- ? Ngritja e nivelit të sigurisë në komunikacion për të gjithë banorët e fshatit Kovragë dhe fshatrave përreth
- Krijimi i kushteve për një jetë më të qetë dhe zvogëlimi i viktimave në komunikacion
- Ngritja e nivelit të sigurisë për nxënësit e shkollës fillore në Kovragë, të cilët vijojnë shkollën nga fshatra të ndryshme përreth.

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit Kovragë dhe fshatrave tjera përreth, fëmijët e të cilëve vijojnë mësimin në shkollën e fshatit. Përfitues i drejtpërdrejtë është shkolla pasi nxënësit më nuk ndihen të rrezikuar gjatë kalimit për të vijuar mësimin në këtë shkollë. Ky projekt do të ndikojë edhe në sigurinë në komunikacion, ku më ndërtimin e nënkalimi nuk do të ketë viktimë në trafik gjatë kalimit të rrugës.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të ndërtohej një nënkalim, më një gjatësi prej 10 metrave dhe një gjerësi prej 2 metrave. Në të dyja anët do të jenë të ndërtuara shkallet për hyrje dhe dalje, në brendësi do të vendoset edhe ndriçimi për t'u ofruar kushte më të mira nxënësve dhe banorëve gjatë kalimit nëpër këtë nënkalim.

### 3.7 Fshati Gusar

Fshati Gusar gjendet ne kilometrin e 6 të rrugës magjistrale Gurrakoc- Mitrovicë. Është fshat me banim të përzier nga komunitetet në të cilin jetojnë afërsisht 34 familje, ku shumica e banorëve i takojnë komunitetit egjiptian. Fshati Gusar është ndër fshatrat të cilët janë në varfëri si shumë probleme të tjera më të cilat ballafaqohen komunitetet.

Ndër problemet kryesore në këtë fshat janë ato të zhvillimit ekonomik dhe të papunësisë së skajshme, edukimi, shëndetësia, njëherit edhe problemet me infrastrukturë janë të theksuara shumë. Një pjesë e banorëve të fshatit Gusar merren më shumë me blegtori dhe bujqësi, pasi që edhe të ardhurat familjare janë nga bujqësia dhe blegtorja, ndërsa një pjesë tjetër e banorëve të ardhurat familjare i sigurojnë nga familjarët e tyre të cilët jetojnë jashtë vendit. Shërbimet mjekësore banorët e këtij fshati i kryejnë në ambulancën e Gurrakocit ose në Istog, që ndodhen larg fshatit Gusar.

Titulli i Projektit: Rregullimi i rrugës për fshatin Gusar

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja:  
2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gusar, Istog

Buxheti: 80.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për fshatin Gusar, përmes rregullimit të rrugës që lidh fshatin Gusar dhe rrugën magjistrale Gurrakoc-Mitrovicë. Rruga do të ndihmojë edhe në përmirësimin e kushteve të jetës për të gjithë banorët e fshatit ku jetojnë komunitetet egjiptian e shqiptar.

Objektivat:

- ? Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve të kësaj zone
- Lehtësim në vijimin e shkollës për nxënësit e fshatit Gusar
- Ngritja e nivelit të sigurisë për nxënësit në trafik

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit Gusar, nxënësit e këtij fshati të cilët vijojnë mësimin në shkollën fillore në Kovragë.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të shtrohet rruga që ndërlidh fshatin Gusar me rrugën kryesore magjistrale Gurrakoc, Mitrovicë. Rruga do të shtrohet me asfalt për të ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetës së banorëve të këtij fshati si dhe fshatrave përreth, njëherit rruga do të shtrohet në gjatësi prej 1 kilometri dhe gjerësi prej 3 metra. Projekti për rregullimin e rrugës është ndër prioritetet e këtij komuniteti në këtë fshat.

Titulli i Projektit:  
Fuqizimi i komuniteteve përmes kurseve të floktarisë dhe rrobaqepësisë

Sektori: Edukim / Rini

Kohëzgjatja:  
6 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gusar-Istog

Buxheti: 5.000 €

Qëllimi i projektit:  
Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e grupit të grave dhe femrave përmes kurseve të floktarisë dhe rrobaqepësisë.

Objektivat:

- ? Profesionalizimi i komunitetit përmes kurseve adekuate profesionale të rrobaqepësisë dhe floktarisë
- Ngritja e kapaciteteve të grave dhe femrave përmes kurseve dhe trajnimeve të ndryshme mbi lëmin e rrobaqepësisë dhe floktarisë
- Krijimi i kushteve më të mira për grupet e grave dhe femrave përmes kurseve të ndryshme

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë grupet (gratë dhe femrat) të cilat i takojnë moshës nga 18 - 40 vjeçare. Njëherit përfitues më direkt do të jenë femrat të cilat kanë më shumë prirje në këtë lami.

Qasja:

Sipas këtij projekti do bëhet realizimi e këtyre kurseve, të cilat ndikojnë pozitivisht në ngritjen e kapaciteteve të grave dhe femrave të komuniteteve rom, egjiptian në fshatin Gusar. Në këtë fshat për 10 vite me radhë nuk është realizuar asnjë aktivitetet, i cili do të ndikonte në të mirë të komuniteteve të cilët jetojnë në këtë fshatë, që është ndër fshatrat me më shumë banorë, shumica që i takojnë moshës së re. Afërsisht 70 të rinj jetojnë në këtë fshat dhe asnjë nga ta nuk ka pasur mundësinë e realizimit të ndonjë aktiviteti apo kursi çfarëdo. Projekti për kurset për floktari, rrobaqepësi do të mbahet në dy grupe të veçanta me orare të ndryshme, pasi që interesimi është shumë i madh nga femrat dhe gratë e këtij fshati, të cilat ndihen të anashkaluara nga shoqëria. Po ashtu duhet të investohet edhe në krijimin e kushteve për realizimin e këtyre kurseve, duke u pajisur me makina qepëse, materiale të ndryshme për floktari dhe rrobaqepësi.

Vet komuniteti siguron hapësirën ku do të jetë e mundur realizimi i shumë aktiviteteve.

Titulli i Projektit: Kurse profesionale për gjuhë dhe kompjuterë

Sektori: Rini

Kohëzgjatja:  
12 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gusarë-Istog

Buxheti: 12.000 €

Qëllimi i projektit:

Të ofrojë kurse për 100 të rinj të këtij fshati, si dhe avancimin e të rinjve të komunitetit rom dhe egjiptian në shoqëri. Të profesionalizojë të rinjtë në fushën e informatikës(kompjuter), dhe gjuhë të huaja (angleze dhe gjermane) gjë që do të ndihmojë në punësimin e këtyre të rinjve.

Objektivat:

- ? Ngritja profesionale e të rinjve për të punuar
- Organizimi i të rinjve për zhvillimin e rinisë në zonat rurale
- Krijimi i një qendre rinore

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë të rinjtë e fshatit Gusar, duke mësuar për përdorimin e punës me kompjuter dhe gjuhëve të huaja, si gjë më elementare për t'u punësuar. Do të përfitojë edhe shoqëria, sepse rinisë së Istogut do t'i shtohet edhe një kuadër profesional në fushën e Informatikës dhe gjuhëve të huaja nga komuniteti rom dhe egjiptian

Qasja:

Do të mbahen kurse tri herë në javë me nga dy orë për kompjuter, gjuhë angleze dhe gjermane. Do të blihen 10 kompjuterë për mbajtjen e kursit të kompjuterëve, si dhe libra për mbarëvajtjen e kursit për gjuhë të huaja. Të rinjtë do të jenë të ndarë në tri grupe më nga 20 veta, që do të mësojnë nga katër muaj secili grup.



### 3.8 Istogu i Poshtëm

Istogu i Poshtëm është kryesisht i banuar me komunitetin egjiptian e shqiptar dhe gjendet afër qytetit të Istogut. Afërsisht në këtë fshat jetojnë 100 banorë të komunitetit egjiptian.

Edhe pse Istogu i Poshtëm është shumë afër qytetit të Istogut, komuniteti në këtë pjesë ballafaqohet me probleme të ndryshme siç është problemi në zhvillimin ekonomik dhe punësim pasi që në këtë fshat është një numër shumë i vogël i të punësuarve në institucione publike dhe private.

Kryesisht një pjesë a familjeve të komunitetit egjiptian në Istogun e Poshtëm jetojnë nga ndihma sociale, ndërsa pjesa tjetër e komunitetit jeton kryesisht nga të ardhurat nga familjarët e tyre të cilët jetojnë jashtë vendit, por edhe ato familje të cilat të ardhurat financiare i sigurojnë nga puna bujqësore, punë fizike. Po ashtu në këtë lokalitet ka mungesa të ndryshme si ato në infrastrukturë, edukim dhe shëndetësi.

Titulli i Projektit: Rregullimi i rrugës Istog i Poshtëm

Spektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja:  
8 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Istogu i Poshtëm

Buxheti: 30.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për Istogun e Poshtëm. Përmes rregullimit të rrugës që lidhe Istogun e Poshtëm dhe rrugën me qytetin e Istogut, ku njëherit do të ndihmojë edhe në përmirësimin e kushteve të jetës për të gjithë banorët e kësaj pjese.

Objektivat:

- Vij imi i m°simit të rregullt në shkollën fillore nga nxënësit e këtyre fshatrave
- Përmirësimi i kushteve në infrastrukturë
- Ngritja e nivelit të sigurisë për nxënësit në trafik

Përfituesit:

Të gjithë banorët e Istogut të Poshtëm si dhe nxënësit e kësaj pjese, të gjithë banorët e fshatit Muzhevinë ku edhe rruga ndërlihd këto dy fshatra mes veti.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të shtrohet rruga do të shtrohet me zhavorr për të ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetës së banorëve të Istogut të poshtëm, njëherit rruga do të shtrohet në gjatësi prej 660 metra dhe gjerësi prej 3 metra. Për shkak të kushteve ekonomike banorët e Istogut të poshtëm nuk kanë mundësinë e participimit, por do të kenë mundësinë e ndihmën fizike.

Titulli i Projektit: Vendorsja e kontejnerëve  
për hedhjen e mbeturinave

Sektori: Shëndetësi dhe Ambient

Kohëzgjatja:  
6 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Istog i Poshtëm

Buxheti: 3.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim të krijojë kushte më të mira dhe ambient më të pastër dhe shëndet më të mirë për të gjithë banorët e Istogut të poshtëm.

Objektivat:

- ? Vendorsja e kontejnerëve për mbeturina brenda lagjes
- Pastrimi i deponive ilegale më mbeturina
- Ofrim i shërbimeve më të mira për mirëmbajtje të ambientit

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e Istogut të Poshtëm të gjitha komuniteteve. Ku do të krijohen kushte më të mira për të jetuar në një ambient më të pastër.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të vendosen 5 kontejnerë në brendësi të lagjes, të pastrohen vendet ilegale nga mbeturinat. Po ashtu ideja e këtij projekti është që të angazhohen edhe kompania për shërbime publike që të ofrojë shërbime më të mira për banorët, pastrimin e kontejnerëve dhe largimin e mbeturinave.

### 3.9 Banja e Pejës

Fshati Banjë e Pejës është kryesisht i banuar me komunitetin rom egjiptian dhe shqiptar. Afërsisht në këtë fshat jetojnë 130 banorë të komunitetit egjiptian dhe rom.

Banorët e fshatit Banja e Pejës ballafaqohen me probleme të ndryshme siç është problemi në zhvillimin ekonomik dhe punësim pasi që në këtë fshat është shumë prezent edhe fenomeni i papunësisë pothuajse total për komunitetin rom dhe egjiptian.

Kryesisht një pjesë a familjeve të komunitetit egjiptian dhe rom në fshatin Banjë jetojnë nga ndihma sociale, ndërsa pjesa tjetër e komunitetit jetojnë kryesisht nga të ardhurat nga familjarët e tyre të cilët jetojnë jashtë vendit. Ata pak banorë të cilët merren me punimin e tokave bujqësore dhe nga bujqësia, sigurojnë të ardhurat familjare. Po ashtu banorët e këtij fshati kanë edhe probleme në infrastrukturë sidomos në lagjen ku janë të banuara nga komuniteti rom dhe egjiptian. Ndërsa komunitetet në përgjithësi shërbimet shëndetësore i kryejnë në Banjë pasi që ekziston edhe ambulanca, njëkohësisht edhe nxënësit vijojnë mësimin në shkollën fillore në Banjë.

Titulli i Projektit: Asfaltimi i rrugës në Banjë të Pejës

Sektori: Infrastruktura

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Banjë, Istog

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim përmirësimin e kushteve në infrastrukturë për komunitetin rom dhe egjiptian, të cilët jetojnë në fshatin Banjë e Pejës.

Objektivat:

- ? Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve romë dhe egjiptianë
- Vijimi i mësimin me rregull në shkollën fillore nga nxënësit e kësaj lagje
- Rritja e besueshmërisë së komuniteteve që jetojnë në këtë lagje të banuar nga komunitetet rom dhe egjiptian.

Përfituesit:

Banorët të cilët jetojnë në këtë fshat, e në veçanti komunitetet rom dhe egjiptian të cilët jetojnë në kushte të vështira infrastrukturore. Njëkohësisht përfitues do të jenë dhe ato familje të cilat do të kthehen si të zhvendosur nga vendet e tjera të rajonit.

Qasja:

Në kuadër të këtij projekti do të asfaltohet rruga gjatë lagjes ku është e banuar me komunitetet rom dhe egjiptian. Rruga në fjalë është shumë e dëmtuar sidomos nga të reshurat atmosferike. Rruga që do të asfaltohet dhe është në gjatësinë prej 600 m dhe gjerësinë prej 3 metra.

### 3.10 Fshati Dubravë

Fshati Dubravë është kryesisht fshat i banuar me komunitetet egjiptian dhe shqiptar ku jetojnë afërsisht 15 familje egjiptiane me 90 banorë. Fshati Dubravë është fshat shumë specifik pasi që në këtë fshat në kohën para konfliktit të vitit 98 ka qenë kryesisht i banuar me një numër të madh të familjeve egjiptiane por edhe të komunitetit serb. Fshati Dubravë është fshat ku është bërë kthimi i familjeve të komunitetit egjiptian.

Problematikat më të cilët përballet ky fshat janë të shumta siç janë papunësia është në nivelin më të lartë në këtë fshat, pothuajse asnjë nuk është i punësuar. Shumica e familjeve jetojnë nga bujqësia primitive si dhe nga ndihmat sociale. Fshati Dubravë në krahasim me disa fshatra të tjera të cilët kanë probleme të theksuara në infrastrukturë në mungesë të vendeve për të realizuar aktivitete të ndryshme sidomos për të rinjtë.

Fshati nuk i ka këto probleme pasi që në Dubravë infrastruktura është e kënaqshme, po ashtu ekziston edhe qendra e komuniteteve, por që nuk shfrytëzohet nga askush madje as nga të rinjtë, si shkak i mos aktivizimit të komunitetit në këtë fshat. Fshati Dubravë ka edhe shkollën fillore në qendër të fshatit, po ashtu edhe ambulancën, e cila është ndërtuar para disa viteve nga organizata të ndryshme të cilat kanë punuar në këtë fshat.

Titulli i Projektit: Riaktivizimi dhe fuqizimi i komuniteteve në fshatin Dubravë

Sektori: Edukim - Rini

Kohëzgjatja:  
1 Vit (duke filluar nga Viti 2009)

Vendi: Dubravë, Istog

Buxheti: 30.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për synim të fuqizojë dhe përkrah grupet e grave dhe të rinjve të fshatrave Dubravë, përmes kurseve dhe trajnimeve të ndryshme mbi gjuhët e huaja si dhe kurset për floktari e kompjuterë.

Objektivat:

- ? Vënia në funksion e qendrës së komuniteteve në fshatin Dubravë përmes aktiviteteve të ndryshme.
- Aftësimi i grupit të grave të komuniteteve mbi kurset dhe trajnimet në lëmin e floktarisë dhe rrobaqepësisë si dhe të kompjuterëve në kuadër të Qendrës.
- Aftësimi i të rinjve mbi gjuhët e huaja dhe kompjuterikes.

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit Dubravë, e në veçanti grupet e grave, femrave si dhe të rinjve të fshatit.

Qasja:

Ky projekt do të fokusohet në aktivizimin e komunitetit të fshatit Dubravë si dhe të funksionimit sa më të mirë të qendrës për komunitete në fshat e cila deri më tani nuk ka funksionuar. Fshati Dubravë ka qendrën të ndërtuar shumë mirë dhe në gjendje të mirë, mirëpo mungon aktivizimi i grupeve të komunitetit. Ideja e këtij projekti është që të rinjtë të kenë kurse dhe trajnime të ndryshme të kompjuterëve dhe gjuhëve të huaja në kuadër të qendrës, që do të ndihmonin në aktivizimin e të rinjve si dhe funksionimin sa më të mirë të qendrës. Po ashtu edhe grupi i grave dhe femrave të reja, do të kenë mundësinë e ndjekës se kurseve për rrobaqepësi dhe floktari në kuadër të kësaj qendre.

Ideja e këtij projekti ka dalë si nevojë e komunitetit pasi që në këtë fshat ka mungesë të aktiviteteve dhe njohurive të përgjithshme sidomos në gjuhën angleze, kompjuterë si dhe floktari dhe rrobaqepësi.

# IV. Buxheti





# Buxheti

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Koha	Euro	Totali në EURO
<b>1</b>	<b>Edukim dhe Rini</b>				<b>140,400.00</b>
<b>1.1</b>	<b>Fshatrat Drejë e Oprashkë</b>				<b>15,400.00</b>
1.1.1	Sigurimi i transportit për nxënës	1	24	641.67	15,400.00
<b>1.2</b>	<b>Fshati Cërcë</b>				<b>90,000.00</b>
1.2.1	Ngritja e nivelit të diturisë	1	12	7,500	90,000.00
<b>1.3</b>	<b>Fshati Gusar</b>				<b>5,000.00</b>
1.3.1	Fuqizimi i komuniteteve përmes kurseve të floktarisë dhe rrobaqepësisë	1	6	833.33	5,000.00
1.3.2	Kurse profesionale për gjuhë dhe kompjuterë	1	12	1,000.00	12,000.00
<b>1.4</b>	<b>Fshati Dubravë</b>				<b>30,000.00</b>
1.4.1	Riaktivizimi dhe fuqizimi i komuniteteve në fshatin Dubravë	1	12	2,500.00	30,000.00
<b>2</b>	<b>Punësimi dhe zhvillimi ekonomik</b>				<b>1,324,500.00</b>
<b>2.1</b>	<b>Fshati Zallq</b>				<b>220,000.00</b>
2.1.1	Asfaltimi i rrugës Zallq	1	8	21,250.00	170,000.00
2.1.2	Ujësjellësi për fshatin Zallq	1	9	5,555.56	50,000.00
<b>2.2</b>	<b>Bashkësia Lokale Gurrakoc</b>				<b>225,000.00</b>
2.2.1	Vendosja e trafo-stacionit të ri	1	12	2,083.33	25,000.00
2.2.2	Furnizimi i komunitetit me pajisje për zhvillimin e bujqësisë në Gurrakoc	1	12	5,000.00	60,000.00
2.2.3	Ndërtimi i Qendrës për komunitete në Gurrakoc	1	24	5,416.67	130,000.00
2.2.4	Rregullimi i rrugës Gurrakoc - Tomoc	1	6	1,666.67	10,000.00
<b>2.3</b>	<b>Fshatrat Drejë e Oprashkë</b>				<b>339,500.00</b>
2.3.1	Rregullimi i rrugës Drejë-Zallq	1	4	3,000	12,000.00
2.3.2	Rregullimi i kanalizimit për fshatin Drejë - Oprashkë	1	12	6,667	80,000.00
2.3.3	Ndërtimi i Trafostacionit të ri	1	10	5,000	50,000.00
2.3.4	Ndërtimi i kooperativës Bujqësore në fshatin Drejë	1	16	10,000	160,000.00
2.3.5	Riparimi i rrjetit elektrik	1	9	4,167	37,500.00
<b>2.4</b>	<b>Fshati Cërcë</b>				<b>350,000.00</b>
2.4.1	Asfaltimi i rrugës Cërcë-Trushevinë	1	10	25,000.00	250,000.00
2.4.2	Ndërtimi i mini fermës dhe fuqizimi i saj	1	36	2,777.78	100,000.00
<b>2.5</b>	<b>Fshati Kovragë</b>				<b>80,000.00</b>
2.5.1	Asfaltimi i rrugës Kovragë	1	13	6,153.85	80,000.00
<b>2.6</b>	<b>Fshati Gusar</b>				<b>80,000.00</b>
2.6.1	Rregullimi i rrugës për fshatin Gusar	1	24	3,333.33	80,000.00
<b>2.7</b>	<b>Istogu i Poshtëm</b>				<b>30,000.00</b>
2.7.1	Rregullimi i rrugës Istog i Poshtëm	1	8	3,750.00	30,000.00
<b>2.7</b>	<b>Banja e Pejës</b>				<b>50,000.00</b>
2.7.1	Asfaltimi i rrugës në Banjë të Pejës	1	12	4,166.67	50,000.00
<b>3</b>	<b>Shëndetësia dhe çështjet sociale</b>				<b>19,000.00</b>
<b>3.1</b>	<b>Bashkësia Lokale Gurrakoc</b>				<b>6,000.00</b>
3.1.1	Vendosja e kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave	1	4	1,500.00	6,000.00
<b>3.2</b>	<b>Fshati Kovragë</b>				<b>10,000.00</b>
3.2.1	Vizitat mjekësore për banorët e fshatit Kovragë	1	12	833.33	10,000.00
<b>3.3</b>	<b>Istogu i Poshtëm</b>				<b>3,000.00</b>
3.3.1	Vendosja e kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave	1	6	500.00	3,000.00
<b>4</b>	<b>Anti diskriminimi, siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi</b>				<b>50,000.00</b>
<b>4.1</b>	<b>Fshati Kovragë</b>				<b>50,000.00</b>
4.1.1	Ndërtimi i nënkalimit në fshatin Kovragë	1	24	2,083.33	50,000.00
<b>5</b>	<b>Të drejtat e femrave</b>				<b>10,000.00</b>
<b>5.1</b>	<b>Bashkësia Lokale Gurrakoc</b>				<b>10,000.00</b>
5.1.1	Profesionalizimi i komunitetit përmes kurseve profesionale	1	12	833.33	10,000.00
					0.00
	<b>Overall Total (1+2+3+4+5+6)</b>				<b>1,543,900.00</b>

Parashikimi i buxhetit në këtë pasqyrë financiare i referohet vetëm pjesës së tretë, ndërhyrjes me projekte në komunitet. Pjesa e dytë në të cilat hyjnë iniciativat dhe rekomandimet nuk është buxhetuar, për shkak se autorët e strategjisë mendojnë se këto rekomandime mbesin orientime të vazhdueshme për punën me komunitetin.

V.  
Foto













